



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 29 (827833)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 21 korrik 2023

Shefi i SHP të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji, vizitë zyrtare në SHBA

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në muajin Skorrik 1993, krijuan Programin e Partneritetit Shtetëror (SPP) që bashkon 100 vende të botës me Gardën Kombëtare, në ndihmë të rritjes së sigurisë rajonale dhe interesave të influencës gjeopolitike, një partneritet që kalon kufijtë ushtarakë të bashkëpunimit, duke u fokusuar gjithashtu në fusha të tjera si: reagimi ndaj emergjencave civile, edukimi, zhvillimi ekonomik, në sektorët e tjerë civilë, përkujdesi

shëndetësor, qeverisja e mirë etj. Programi i Partneritetit Shtetëror prodhon marrëdhënie të shkëlqyera e të qëndrueshme që përmirësojnë ndërveprueshmërinë, rrisin aksesin dhe gatishmërinë e forcave të SHBA-ve dhe vendeve partnere për të përballuar sfidat e reja. "Ky program i përgjigjet Strategjisë së Mbrojtjes së SHBA-së, ku aleancat dhe partneritetet me përfitim reciprok janë një forcë e qëndrueshme dhe kritike për vitet në vijim", - sikundër është shprehur gjeneral

Hokanson, shefi i Byrosë së Gardave Kombëtare, i cili njëkohësisht menaxhon dhe administron ecurinë e Programit të Partneritetit Shtetëror. Shqipëria është pjesë e këtij programi bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të Nju Xhersi, që nga viti 2001. Në këto 22 vite bashkëpunimi bilateral dhe miqësie, vlen të theksohet se Shqipëria dhe Nju Xhersi kanë një nga programet më aktive të bashkëpunimit, veçanërisht vitet e fundit, ku më shumë se...



»» faqe 2

Ministri Peleshi: Politika e jashtme e Shqipërisë, e orientuar drejt fqinjësisë dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor



»» faqe 3

Kursantët e KKSHP dhe KLO testojnë dijet

Ditët e fundit të kursit për kursantët e KKSHP dhe KLO, janë ditë jo të zakonshme mësimi, pasi ata po mbrojnë temat kursore të planifikuara në përfundim të kursit. Kursantët sollën në temat e tyre çështje që kanë të bëjnë me sfidat dhe nevojat që kanë Forcat e Armatosura të RSH dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Mbrojtja e këtyre temave solli në auditorët e kolegjit përvojën dhe eksperiencat e tyre në misione, përfaqësi ushtarake...



»» Faqe 4

Anija "Butrinti", pjesë e operacionit për shpëtimin e 52 emigrantëve nga Sudani dhe Jemeni

Anija shqiptare "Butrinti" ishte pjesë e operacionit, ku u shpëtuan 52 emigrantë nga Sudani dhe Jemeni nga një gomone në rrezik në brigjet turke, falë bashkëpunimit mes Rojës Bregdetare greke dhe asaj turke. Ky operacion i suksesshëm tregon rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit mes vendeve në luftën kundër emigracionit të paligjshëm dhe trafikut të qenieve njerëzore. Nga ana e tij Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh: "Krenarë që efektivët tanë, pjesë e misionit SNMG2 TU 01, vazhdojnë të bëjnë një punë të jashtëzakonshme dhe të jenë...



»» Faqe 4

"Një popull që ka harruar të kaluarën e tij është i dënuar të humbasë"

Lufta përmes syve të fëmijëve modernë Kujtim i çuditshëm njerëzor, shqiptarët e moshës 40 vjeç e lart janë të fundit për të cilët fjala "luftë" do të thotë një luftë shumë specifike. Në fund të fundit, është fare e qartë se lidhja e kohërave është prishur. Se kodet kulturore të përbashkëta për të gjithë njerëzit e moshës dyzet e më shumë (dhe prindërit e tyre që tashmë kanë vdekur) po vjetërsohen para syve tanë, duke vdekur si një bisht atavist. Kështu funksionon evolucioni, e panevojshmja zhduket. Përveç kësaj, ne duhet të jemi realistë, nuk ka gjasa që gjatë luftës së ardhshme patriotike, nëse ndodh...



»» Faqe 5

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji, vizitë zyrtare në SHBA

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në muajin korrik 1993, krijuan Programin e Partneritetit Shtetëror (SPP) që bashkon 100 vende të botës me Gardën Kombëtare, në ndihmë të rritjes së sigurisë rajonale dhe interesave të influencës gjeopolitike, një partneritet që kalon kufijtë ushtarakë të bashkëpunimit, duke u fokusuar gjithashtu në fusha të tjera si: reagimi ndaj emergjencave civile, edukimi, zhvillimi ekonomik, në sektorët e tjerë civilë, përkujdesi shëndetësor, qeverisja e mirë etj.

Programi i Partneritetit Shtetëror prodhon marrëdhënie të shkëlqyera e të qëndrueshme që përmirësojnë ndërveprueshmërinë, rrisin aksesin dhe gatishmërinë e forcave të SHBA-ve dhe vendeve partnere për të përballuar sfidat e reja. "Ky program i përgjigjet Strategjisë së Mbrojtjes së SHBA-së, ku aleancat dhe partneritetet me përfitim reciprok janë një forcë e qëndrueshme dhe kritike për vitet në vijim", - sikundër është shprehur gjeneral Hokanson, shefi i Byrosë së Gardave Kombëtare, i cili njëkohësisht menaxhon dhe administron ecurinë e Programit të Partneritetit Shtetëror.

Shqipëria është pjesë e këtij programi bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit, që nga viti 2001. Në këto 22 vite bashkëpunimi bilateral dhe miqësie, vlen të theksohet se Shqipëria dhe Nju Xhersi kanë një nga programet më aktive të bashkëpunimit, veçanërisht vitet e fundit, ku më shumë se 1000 efektive të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit dhe efektive të Forcave të Armatosura të RSH, kanë zhvilluar trajnime dhe stërvitje të përbashkëta me fokus zhvillimin e kapaciteteve dhe procesit të mirëmbajtjes logjistike, aftësimin e trupës së nënofficerëve dhe oficerëve, përmirësimin e procedurave standarde ushtarake mjekësore, mbrojtjen kundër armëve të dëmtimit në masë, përdorimin e teknikës së re të armatimit, zhvillimit të kapaciteteve kundër mjeteve shpërthyes, minave etj.

Pjesëmarrja jonë në stërvitjet shumëkombëshe "Defender Europe - 21" dhe "Defender Europe - 23" ishte një mundësi e shkëlqyer e vendit dhe Forcave të Armatosura, të testojnë nivelet e gatishmërisë dhe aftësive në realizimin e skenarëve të ndryshëm ushtarakë. Përmbyllja me sukses e të dy stërvitjeve, i hapi rrugë mundësisë së zhvillimit të stërvitjeve të tjera të radhës "Defender Europe 2024 dhe 2025".

Një mbështetje e jashtëzakonshme është dhënë në konsolidimin e Grup - Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, në trajnim, standardizim rregulloresh dhe procedurash, realizim stërvitjesh të përbashkëta në të gjitha nivelet, brenda dhe



jashtë vendit (në Fort Drum, New York) si dhe asistencë me grupe këshillimi gjatë procesit të certifikimit sipas sistemit të NATO, CREVAL si njësi "Combat Ready", në shtator 2022.

Ecuria e suksesshme e partneritetit me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit (GKNJ) është reflektim i marrëdhënieve të shkëlqyera me aleatin tonë strategjik dhe mik të shqiptarëve. Instalimi i ekipeve të shumta trajnuese amerikane në Shqipëri si: Task Force Balkans e Forcave Speciale, Brigada e Asistencës së Forcave të Sigurisë, asistencë e këshilltarëve për personelin, planifikimin dhe donacionet e ndryshme, kanë bërë të mundur që Forcat e Armatosura të jenë në rrugën e duhur të zhvillimit dhe modernizimit të saj në teknike, pajisje, armatim, në procedura dhe doktrina në përputhje me standardet perëndimore ushtarake, në fushën e mbrojtjes kibernetike, trajnimin e pilotëve, në procesin e transformimit të sistemit arsimor ushtarak në trajnimin e stafëve,

përmirësimin e kurrikulave dhe zhvillimin e rregulloreve, duke u bazuar në standardet e sistemit të akademisë "West Point". Të gjitha këto bashkëpunime kanë qenë faktor i promovimit të



miqësisë dhe lidhjeve të ngushta mes dy ushtrive tona.

"SHBA është aleati ynë më i rëndësishëm dhe i jemi mirënjohës për bashkëpunimin dhe marrëdhënien e shkëlqyer, që ekziston mes dy vendeve tona. Mbështetja që na kanë dhënë ndër vite, ka përmirësuar kapacitetet operacionale dhe ndërvepruese të Forcave tona të Armatosura. Duke ndjekur historitë e mëparshme shumë - dimensionale të suksesit, ky bashkëpunim do të jetë gjithnjë e në rritje në vitet në vijim", - deklaroi gjeneralmajor Arben Kingji, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjatë takimit me gjeneral Daniel R. Hokanson, shefin e Byrosë së Gardave Kombëtare, përgjatë vizitës në Shqipëri.

Nisja e një sërë projektesh të rëndësishme

të modernizimit me SHBA-të, duke u bazuar në ndryshimet e fundit në strukturën e Forcave të Armatosura, krahas bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit, mbështetja me ndihma dhe ekipe këshilluese nëpërmjet programeve të ndryshme të Departamentit Amerikan kanë bërë të mundur që Forcat e Armatosura të rrisin kapacitetet operacionale, me qëllim që të jenë të ndërveprueshme me vendet anëtare në NATO, dhe të gatshme t'i përgjigjen në çdo kohë, sfidave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Në datat 17 - 18 korrik 2023, shënohet 30 - vjetori i krijimit të Programit të Partneritetit Shtetëror, ku zyrtarë të lartë politikë dhe ushtarakë nga 100 vende të botës u mbledhën në Maryland, SHBA, në konferencën që u organizua për këtë event. Përfaqësuesi i Shqipërisë ishte shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji.

Përgjatë konferencës 2 - ditore panelet e drejtuara nga të ftuar nderi: gjeneral Mark Milley, shefi i Shefave të Shtabeve të Ushtrisë Amerikane, gjeneral Daniel R. Hokanson, shefi i Byrosë së Gardave Kombëtare dhe përfaqësues të tjerë të lartë nga Departamenti Amerikan i Mbrojtjes, diskutuan tema mbi: kërcënimet ndaj sigurisë globale, bashkëpunimin ushtarak dhe sigurinë kibernetike.

"Qëllimi i vërtetë i këtyre programeve është ndërtimi i lidhjeve të forta e të qëndrueshme njerëzore dhe më pas ushtarake, ku oficerët e rinj të sotëm përgjatë viteve do të promovohen në poste të rëndësishme ushtarake dhe civile, dhe do të kenë një këndvështrim mirëkuptues dhe me respekt kundrejt Shteteve të Bashkuara", - deklaroi gjeneral Daniel R. Hokanson.

Shqipëria është anëtare e iniciativave të ndryshme rajonale si: Adriatik 5 (A5), Balkan CHOD-s, DECI, SEDM, RACVIAC, BMTF, vendi ynë është i angazhuar plotësisht në

promovimin e paqes në rajon, si dhe është i palëkundur në rrugën drejt integritetit në Bashkimin Evropian. Është mbështetëse e dialogut Kosovë-Serbi, si një ndër hapat parësorë për ruajtjen e qëndrueshmërisë së sigurisë në rajon dhe vlerëson rolin dhe përpjekjet e SHBA-së dhe BE-së për këtë qëllim.

Falë ftesës së SHBA-së, vendi ynë për herë të parë merr pjesë me efektive të saj në misionin e "Forcës Shumëkombëshe dhe e Vëzhguesve" në Sinai, Egjipt, ku pritet që në vitet në vijim të zgjerohet harta gjeografike e kontributeve tona në misione ndërkombëtare. Krijimi, ruajtja dhe intensifikimi i marrëdhënieve efektive të zgjatura në kohë është një ndër prioritetet e bashkëpunimit ushtarak me Shtetet e Bashkuara.





Ministri i Mbrojtjes, zoti Niko Peleshi, zhvilloi një vizitë zyrtare në Britaninë e Madhe. Ministri Peleshi u prit në një takim nga sekretari Shtetit për Mbrojtjen Ben Wallace.

Në këtë takim z. Peleshi shprehu mirënjohjen për mbështetjen që Ministria e Mbrojtjes së Britanisë ka dhënë për Forcat e Armatosura shqiptare. Nga ana e tij, sekretari Wallace shprehu gatishmërinë për intensifikimin e këtij bashkëpunimi në kuadër të Aleancës, por dhe në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe rajonal.

Po ashtu ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u prit nga ministrja e Shtetit baronesha Goldie DL. Të dy ministrat nënshkruan Deklaratën e Përbashkët mbi Rritjen e Bashkëpunimit dypalësh në fushën e Mbrojtjes, dokument i cili synon përfundimin e bashkëpunimit aktual, identifikimin e fushave të reja të bashkëpunimit për të përballuar sfidat si dhe për t'iu përshtatur risive të reja që sjell koha dhe mjedisi gjithnjë e më shumë konkurrues dhe kompleks.

Si dy vende anëtare të NATO-s, ministrat rikonfirmuan vendosmërinë e tyre për të vijuar kontributin në sigurinë ndërkombëtare, duke përfshirë mbështetjen e vazhdueshme për Ukrainën, si dhe rritjen e angazhimit për sigurinë e Ballkanit Perëndimor dhe krahut jugor të NATO.

Një tjetër takim, ministrit Peleshi iu rezervua nga kreu dhe disa anëtarë të grupit parlamentar shumë-partiak për Shqipërinë, ku diskutuan mbi zhvillimet e fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjatë këtij takimi ministri Peleshi theksoi se politika e jashtme e Shqipërisë është gjithmonë e më shumë e orientuar drejt fqinjësisë së mirë, sigurisë dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor.

Ministri Peleshi u prit në një takim të veçantë nga i dërguari i posaçëm i kryeministrit britanik për Ballkanin Perëndimor sir Stuart Peach, një mik i hershëm i Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Gjatë këtij takimi u diskutuan çështje me interes për zhvillimin, sigurinë, stabilitetin e Ballkanit Perëndimor, rolin e Shqipërisë në rajon, ku një vëmendje të veçantë i kushtua çështjes së Kosovës.

Ministri Peleshi: Politika e jashtme e Shqipërisë, e orientuar drejt fqinjësisë dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor



Si dy vende anëtare të NATO-s, ministrat rikonfirmuan vendosmërinë e tyre për të vijuar kontributin në sigurinë ndërkombëtare, duke përfshirë mbështetjen e vazhdueshme për Ukrainën, si dhe rritjen e angazhimit për sigurinë e Ballkanit Perëndimor dhe krahut jugor të NATO.

Në Britaninë e Madhe, një vend të rëndësishëm ministri Peleshi i dha dhe vizitës në JHubDefence, qendër e inovacionit të Komandës Strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, "Aty ku ndërlihet teknologjia dhe talenti i klasit botëror me përdoruesit në të gjithë sistemin e mbrojtjes.

Një shembull për Qendrën e re të Inovacionit që do të hapet së shpejti edhe në Shqipëri", - u shpreh ministri Peleshi.



Kursantët e KKSHP dhe KLO testojnë dijet

Ditët e fundit të kursit për kursantët e KKSHP dhe KLO, janë ditë jo të zakonshme mësimi, pasi ata po mbrojnë temat kurse të planifikuara në përfundim të kursit.

Kursantët sollën në temat e tyre çështje që kanë të bëjnë me sfidat dhe nevojat që kanë Forcat e Armatosura të RSH dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Mbrojtja e këtyre temave solli në auditorët e kolegjit përvojën dhe eksperiencat e tyre në misione, përfaqësi ushtarake, trajnime, duke marrë literaturë nga vendi dhe të huaj, duke e bërë më të larmishme gamën e informacionit të prezantuar. Vlen të përmenden tema si: “Rëndësia e gjeoinformacionit në operacionet luftarake”, “Shërbimi SAR në Forcën e Sigurisë së Kosovës”, “Operacionet e informacionit në mbështetje të operacioneve ushtarake”, “Zhvillimi i teknologjisë dhe sfidat e sigurisë kibernetike”, “Përdorimi i avionëve pa pilot, UAV në operacione” etj.

Kursantët u drejtuan për zhvillimin e temës nga pedagogë (mentor) të departamenteve të Operacioneve Ushtarake, Strategjisë dhe Studimeve të Avancuara dhe Udhëheqjes Ushtarake.

Ata treguan përkushtim dhe korrektesë në përgatitjen e tyre, duke ndjekur udhëzimet përkatëse.



Forcat e Armatosura në të gjitha kompeticionet sportive kanë arritur të marrin trofe fitoresh, siç ishte dhe maratona “Illyrian Race”, ku major Bledar Mesi zuri vendin e parë dy herë radhazi. Ndërsa vendin e dytë në këtë garë e zuri studenti i vitit II Bachelor, Përparim Gashi.



Anija “Butrinti”, pjesë e operacionit për shpëtimin e 52 emigrantëve nga Sudani dhe Jemeni

Anija shqiptare “Butrinti” ishte pjesë e operacionit, ku u shpëtuan 52 emigrantë nga Sudani dhe Jemeni nga një gomone në rrezik në brigjet turke, falë bashkëpunimit mes Rojës Bregdetare greke dhe asaj turke.

Ky operacion i suksesshëm tregon rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit mes vendeve në luftën kundër emigracionit të paligjshëm dhe trafikut të qenieve njerëzore.

Nga ana e tij Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh: “Krenarë që efektivët tanë, pjesë e misionit SNMG2 TU 01, vazhdojnë të bëjnë një punë të jashtëzakonshme dhe të jenë shembulli më i mirë i përkushtimit dhe sakrificës”.

Efektivët e FARSH dhe Anijes “Butrinti P-134”, janë pjesë e operacionit të NATO-s “Sea Guardian”, në Detin Egje.

Angazhimet në misionet dhe operacionet jashtë vendit tashmë janë bërë detyra të zakonshme për Forcat tona të Armatosura.

Efektivët tanë, që kanë shërbyer dhe shërbejnë në misione të shumta jashtë vendit me profesionalizëm, kanë fituar respektin dhe besimin e



partnerëve dhe aleatëve, vlerësim, që e bën FA-në të ndjehet krenare për ta, por gjithashtu e vendos përpara

përgjegjësi akoma edhe më të mëdha, për të vepruar në mjedise gjithnjë e më komplekse dhe të paparashikueshme.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Një popull që ka harruar të kaluarën e tij është i dënuar të humbasë”

Lufta përmes syve të fëmijëve modernë

Kujtim i çuditshëm njerëzor, shqiptarët e moshës 40 vjeç e lart janë të fundit për të cilët fjala “luftë” do të thotë një luftë shumë specifike.

Në fund të fundit, është fare e qartë se lidhja e kohërave është prishur. Se kodet kulturore të përbashkëta për të gjithë njerëzit e moshës dyzet e më shumë (dhe prindërit e tyre që tashmë kanë vdekur) po vjetërsohen para syve tanë, duke vdekur si një bisht atavist.

Kështu funksionon evolucioni, e panevojshmja zhduket. Përveç kësaj, ne duhet të jemi realistë, nuk ka gjasa që gjatë luftës së ardhshme patriotike, nëse ndodh një e tillë, ne do të jemi në gjendje të godasim armikun me një bajonetë, të hedhim veten mbi tank me një granatë ose të ngrijmë si një shtyllë e gjallë, akull nga fakti që armiqët do të na derdhnin ujë të ftohtë në të ftohtë të hidhur. Lufta botërore e së ardhmes do të jetë krejtësisht ndryshe, më teknologjike, ose postmoderne. Nëse do të jetë...

“Por, megjithatë, diçka më shqetëson...”

Kur ishim duke u rritur, ne dinim shumë për luftën që nga kopshti, lexuam shumë, dhe vazhdimisht shfaqnin filma për luftën në TV, shpesh kishte shfaqje në radio, luanim luftë, vizatuam luftën, na vinin veteranët në shkollë... Dhe gjyshërit tanë na tregonin për luftën, për bllokadën, dhe fëmijët tanë, më duket, ata disi janë larg nesh pafundësisht në këtë drejtim. Ndoshta ne vetë jemi fajtorë për këtë, ose ndoshta jo vetëm ne...”

Ndoshta, për ta, këto janë ngjarje afërsisht po aq të largëta...

Epo, fëmijët e sotëm do të dinë diçka tjetër, dhe më pas... A e nderon njëri prej nesh kujtimin e të rënëve në betejat e përgjakshme? Kjo është!

Është e trishtueshme, por e natyrshme. Por sa janë gjallë veteranët, ne kemi mundësinë t'u shpjegojmë fëmijëve se çfarë është “lufta”.

A është e mundur që kaq shumë të ketë ndryshuar, sepse në Shqipëri “nuk ka familje të tillë, ku heroi i saj nuk mbahet mend...”.

Teorikisht e di temën, por ato nuk mund të përballojnë të gjithë globalitetin e asaj tragjedie, natyrisht.

Gjithçka varet nga familja, se si familja ua përcjell fëmijëve kujtimin e luftës.

Djali im 17 vjeç, është gjithashtu shumë i interesuar për luftën. Përpiqem t'i shpjegoj, i them, ai shpesh



shikon filma lufte, dëgjon historitë e stërgjyshëve të tij...

Ndoshta, pas disa dekadash, fëmijët do të dinë fare pak për këtë luftë.

Kjo, më duket, do të jetë një parakusht i drejtpërdrejtë për fillimin e një lufte të re, edhe më të tmerrshme...

Po, mjerisht, kujtesa zbehet në të kaluarën...

A jemi në rrezik të amnezisë masive?

Një popull që ka harruar të kaluarën e tij është i dënuar të humbasë!

Nuk e di, ndoshta është gjaku që të bën të perceptosh me kaq dhimbje gjithçka që lidhet me luftën, por edhe me revolucionin.

Unë jam e qetë për fëmijët e mi, ata do të dinë shumë për luftën. Këtu, unë thjesht dua që ata të mos jenë në mesin e bashkëmoshatarëve të tyre “korba të bardhë”...

Për mendimin tim, nuk ka rrugë tjetër. Dhe si mund të harrohet kjo në vendin tonë, nuk e kuptoj këtë! Është e pamundur ta harrosh!

Dhe unë mendoj se Lufta duhet marrë seriozisht.

“Pse ky Hitleri hoqi çatinë e tij dhe shpërtheu gjithë botën?”

Këtu është gabimi ynë kryesor prindëror, ne nuk dimë se çfarë të

përgjigjemi, por është e mundur dhe shumë, shumë e nevojshme t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje. Do të jetë e vështirë, në mënyrë që pa lodhje, gradualisht të fillojë të njihet me historinë, konceptin e ideve nacionaliste dhe veçoritë e zhvillimit të tyre, etj.

Dhe çfarë dinë nxënësit e shkollës për luftën? Çfarë dinë ata për stërgjyshit

dhe stërgjyshërit e tyre, si shkoi lufta në jetën e tyre?

Unë mendoj se njerëzit e sotëm, rinia moderne nuk janë si ata që luftuan në Luftën e Madhe Patriotike. Tani të rinjtë mendojnë në një mënyrë krejtësisht tjetër, tani ka një jetë krejtësisht të ndryshme, hobe të tjera, teknologji të tjera... Por nëse një luftë

ndodh papritur, rinia do të shkojë në luftë në të njëjtën mënyrë dhe do të mbrojë vendin në të njëjtën mënyrë, si brezi që luftoi kundër fashistëve. Edhe pse, nëse fillon lufta, do të jetë krejtësisht ndryshe. Do të ishte më mirë, sigurisht, nuk ishte. Por, gjithçka varet nga politikanët.

Por, i jam shumë mirënjohëse të gjithë veteranëve, gjithë brezit të vjetër që e mbrojtën vendin tonë.

Mendoj se edhe sot njerëzit nuk kanë më pak patriotizëm se sa kishte populli atëherë.

Respekt dhe mirënjohje për veprën tuaj, Veteranë të LANÇ.

Gëzuar 66-vjetorin e krijimit të Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ-it, të popullit shqiptar “Nderi i Kombit”!

Krenohemi me gjithë kontributorët që morën pjesë aktive në formacionet partizane në mal.

Krenohemi me të gjithë atdhetarët që i shndërruan shtëpitë e tyre në spitale partizane dhe vetë shërbyen me të gjithë dashurinë dhe kujdesin njerëzor si personel ndihmës i mjekëve të LANÇ-it.

Uroj të gjithë Pasardhësit e Veteranëve të LANÇ-it, Gëzuar Ditën e Veteranëve! Qoftë i Paharruar 20 korriku në Breza!



Pas 43 vjetësh, mes mallëngjimit e krenarisë frymëzuese



ASLLAN OSMANAJ
Publicist, shkrimtar

Mbresa të paskajshme nga një takim i pjesshëm, pas 43 vjetësh, të ish-studentëve të klasës së tretë të Fakultetit të Artilerisë Tokësore. Bërthama kurrizore bazë ishte skënderbegase, dhe të tjerë të bashkangjitur nga shkollat civile. Për fat kjo klasë ishte e jashtëzakonshme: djem të zgjuar, të çiltër, të dashur e gazmorë dhe të lidhur si një grusht i vetëm. Pa diskutim që ndikim pozitiv solli shoku ynë Muço Muçaj si komandant klase. Të mbash përgjegjësinë e të gjithë shokëve e të kryesh detyrën me përpikëri, pa asnjë hatërmbetje, përbën meritën e risisë së tij të veçantë. Edhe pas shumë vitesh s'kemi hasur e as dëgjuar për ndonjë grup studentor si ky, kaq dinjitoz, i cili skaliti cilësitë më të mira. Dëshmitë e vërtetësisë nuk përbushen vetëm me vitet e shkollës, por edhe me karrierën e arrirë shumëplanëshe, kudo shërbyen e shërbejnë dhe tani.

Mund të jem rasti i vetëm, me "pa numërim" ndërrime detyrash e funksionesh. Kjo "lëvizshmëri" marramendëse më mundësoi për 43 vjet, takim vetëm me pak shokë. Saktësisht, me Dedë Zhivanin ishim bashkëdrejtues në një garnizon në lartësinë e 1281m të Dobrejt, me Adem Ajdinin kur ishte themelues i shkollës private "Flabina", me Hamdi Meçen, në kohën e kryerjes së detyrave të rëndësishme në Gardën e Republikës, ku shkëmbeu ndonjë bisedë të shkurtër me Mehmet Hysin, gjithashtu me Gani Ajazin, tek militonte në dorëzaninë e Rinasit e më vonë në një drekë në familjen e tij në Fushë-Krujë. Herët si "mysafir" ndihmues jam takuar me Vasillaq Ballcën dhe me një shok tjetër, që deri sa të bindet për mungesë të përditësimit të kujtesës, nuk po e njëjtësoj. Në trembëdhjetë muajt e gazetarit ushtarak të Luftës së Kosovës, rastisi që të takohesha shpesh me Nuri Shehun që, veç miqësisë, kishin lidhje me misionin tim e që përkonin me detyrat tona të përbashkëta, po në atë kohë edhe me Vasillaq Ballcën. Në Ministrinë e Mbrojtjes punonim (në sektorë të ndryshëm) me Vasillaqin e Alfred Biraçin (Majko). Vlerësoj shumë këshillat miqësore të tyre. "Rebelimi im gazetaresk" me "egërsi" për drejtësi, ishte i parakohshëm. Vasillaqi "butazi" shprehej e largohej. Me Alfredin "kacafyteshim" e në anën tjetër përplasej me gërrithësit e mi, duke i paralajmëruar: "mos u kruani, se ai do jetë ngadhënjyesi...". Koha e përvujshme i dëshmoi. Pra, pa para as prapa veprim të unit, për 43 vjet, isha më i përkëdheluri që munda të takoj më pak se një të tretën e shokëve.

NISMËTARË DHE ORGANIZUES

Secilin nga ne e brengoste malli e dëshira për t'u takuar me shokët. Adem Ajdini në cilësinë e kryetarit të shoqatës së shkollave ushtarake,



filloi përpjekjet e para. Shpejt iu bashkëngjiten: Mehmet Hysi, Nuri Shehu e Sadik Sula. Vështirësia qëndronte në gjetjen e adresave e telefonave. Veç atyre në Shqipëri, pjesa më e madhe jetonin e punonin në shtetet evropiane e në kontinente të tjera. Pas muajsh hulumtimesh e këshillimesh, u caktua data e bashkimit. Fatqëqësisht e pamundur për praninë e të gjithë të gjallëve. Emocion e makth për njëjtësimin e shokëve. Fantazonim ndryshim e secilit.

Edhe siç doli në pah, sikur të ftoheshim për grada apo poste madhore, gëzimi e malli nuk i ofroheshin aspak kulmit të kësaj dite. Ndjenja ishte vogëlake, përpara kërshtërisë së dashurisë të takimit të shoqërisë së mirë. Nismëtarët nuk na lodhën për skenarët e takimit. Katërshja hartoi deri në copëzat më të vogla mënyrën e organizimit, sa ne të tjerët, ishim spektator komod dhe të befasuar nga mjeshtëria e platformës së tyre. Shkurtazi, e grimcë pas grimcë, po shpalos më thelbësoren.

Ideatori Adem Ajdini me tre të tjerët: M. Hysi, N. Shehu e S. Sula, menduan që fillimisht puqja të bëhej në ish-klasën tonë të Akademisë.

Mjedise që tani i përkasin institucioneve të larta ushtarake, si Ministrisë Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm.

Këto institucione kanë mbështetur çdo veprimtarë që vjen nga linjat e tyre. Është rasti për falënderim për ndihmesë të vazhdueshme, sidomos prej disa funksionarëve: si Tesila Polena, Artan Ajazi, Arben Skënderi, Edmond Guni, Manushaq Shehu, Nazmi Hoxha, Arjan Osmani,

Bilbil Bitri, Arben Toska e të tjerë. Kjo ndihmesë ishte rrugë e hapur edhe për veprimtarinë tonë.

Si skenarist, aktor e regjisor i shumë dokumentarësh, që në derë ngela i shtangur, bashkë me të tjerët. Tërë ballina e klasës polifotoja me fytyrat rinore engjëlllore.

Kamera, fotograf e regjisor. Njëjtësimet e secilës tryezë. Buqeta me lule dhe fotot e mëdha të kornizuara të katër shokëve tanë të dashur që janë larguar nga kjo jetë, të: Zafer Fejzës, Artur Noçkës, Naqo Meleqit. Ndërsa në karrigen e Shemi Sinanit portretin e mbante djali i tij, një informaticien. Sado të parapërgatitur, askush nga ne nuk i mbajti lotët e mallëngjimit. Edhe në pushimin e heshtjes psherëtimim, se shumica



jonë nuk i kishim parë që nga ndarja në përfundim të Akademisë.

Në vijim, secili nga ne, rrëfeu nga pak gjëra të jetës e familjes. Dreka na gjeti me gotat në duar, duke uruar njëri-tjetrin për shëndet dhe mbarësi. Sa shumë kishim për të thënë dhe sa shumë për të kujtuar.

Disi të çliruar bisedonim thjeshtë, "rriteshim", duke nderuar rrugëtimin e ngjitjeve të secilit. Tek kujtesojmë shkallët e ecjeve, qartësohet përparimi, ku shumica përfunduan studimet pasuniversitare në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm. Të tjerë: Fiziolofinë, Gazetarinë, Gjuhë e Letërsi Shqipe, Juridik e shumë shkenca të tjera, duke formësuar nivel vetjak e karriere. U rikujtuam ndodhi gazmore e shpotike të shkollës e jetës. Hamdi Meçe këndoi disa vargje të të ndjerit Naqo Meleqi. Në qoshen tjetër; Mehmet Hysi, Sadik Sula me grupin. Nuri Shehu me vite të suksesshme në Kukës e Tiranë, i dekoruar dy herë e me të tjera vlerësime, dëgjonte si i habitur. Nuri

kujdesej për ushqimet tona me rregullsi. Kur unë e Alfredi iknim, për të na shpëtuar flinte në krevatet tona e merrte vetë mungesë. Me humorin e hollë shpërtheu: "S' e kam ditë, që paskam qenë i mirë!" Alfred Biraçi pas përcjelljes së mesazhit për të ndërjet e urimit. Ne 'përgojuam' si e mbante kapelën edhe kur studionte. Pas viteve në Ministri e në Qendrën e Simulimeve Ushtarake u largua në Nju-Xhersi, punon si një menaxher i arrirë. Komandanti Vasil Koçi nga Kanadaja tha: "E përsëris se ky ka qenë grupi më i mirë që kam përcjellë gjatë jetës time". "Peshkopi" (lexuesi i selitur) Leonidha Shkurti, pas detyrash si pedagog e gazetar ushtarak u vendos në SHBA, ku punon me dinamizëm. Leonidha e dikush tjetër, më kërkuan t'u sillja ndonjë libër timin. Paketova nga pesë tituj librash më të rinj për secilin pjesëtar. Pasi ua shpërndava e që më përgëzuan u vura në siklet. Folëm gati me të gjithë të munguarit, me Grigor Rexhën, Pasho Bedinin e të tjerë. Grigori kishte kaluar një operacion të vështirë. Dhe Leonidha Shkurti (pas takimit) shkoi nga Tirana në Athinë për ta vizituar Grigorin. I mallëngjyer shkruante: "Sikur takova gjithë shokët e nderuar!"

Luto Yzeirit, që mezi po priste takimin, iu sëmur rëndë babai e ngeli nëpër spitale. Vasillaq Ballca, mori gradën "kolonel". Për humor, Ky për "gradën" e Mehmet Hysi edhe për "moshën e gjatësinë" na quanin të "vegjël". A. Ajdini krahas detyrave në Ministrinë e Mbrojtjes e të Brendshme, prej 26 vitesh ushtron avokatin e karrierës. Ruante të vetmin nervozizëm, kur i kritikonim futbollin kavajas. "Si mund të bëhesh oficer, kur je kaq i urtë?", - i thoshin Shaban Haremit. Po Shabani eci shumë si specialist. Që pas lirim, vazhdon edhe tani drejtor i Policisë Bashkiake në Peqin. Dhe çdo vit me kontrollet e KLSH-së është vlerësuar i shkëlqyer. Vetëm Kujtim Lamçen e njohëm menjëherë.

- Ku qëndron sekreti që nuk qenke "vrrarë"



Armët, emblemat e popujve në kohë...

Duke përfutur nga hutimi që shkaktoi në popujt ballkanikë tërheqja e ushtrive austriake, sanxhakbeu i Shkodrës, Sulejman Pasha, kreu po atë vit 2 ekspedita kundër malësorëve, por përsëri orvatjet e tij dështuan. Vetëm në vjeshtë të vitit 1692 ai mundi të hynte në Malin e Zi dhe të pushtonte Zhabiakun dhe Cetinën. Me këtë rast, ai provoi të nënshtronte edhe Malësinë e Madhe, por përsëri nuk pati rezultat. Pas vitit 1692 ushtritë e koalicionit (Austri, Venedik, Poloni) me vështirësi po u bënë ballë sulmeve turke. Me nënshkrimin e "Aleancës së Shenjtë", në tetor të vitit 1696, edhe Rusia hyri në luftë kundër Turqisë. Me hyrjen e saj në luftë, ushtritë e koalicionit filluan të korrin fitore mbi turqit. Për të ndaluar shkatërrimin e Perandorisë Otomane, Anglia me Holandën ndërhyjnë pranë Turqisë dhe Austrisë, për t'i dhënë fund luftës. Bisedimet për paqe filluan më 1698. Me gjithë kundërshtimin e Rusisë e të Polonisë, të cilat shikonin te këto bisedime intrigat e Anglisë e të Holandës, perandori i Austrisë i kërkoi paqe Sulltanit. Kështu, më 1699, u nënshkrua traktati i Karlovacit. Me këtë traktat, Austria i zgjeroi kufijtë deri në lumenjtë Savë dhe Danub, duke arritur në portat e Ballkanit. Veç kësaj, ajo shkëputi nga Perandoria Osmane të drejtën të kishte nën mbrojtje banorët katolikë të Ballkanit, duke përfshirë edhe popullsinë katolike të Shqipërisë. Me këtë i mundësohej Austrisë që të ndërhynte në Shqipërinë e Veriut. Nga ana tjetër, Rusia me paqen që nënshkroi në Stamboll, më 1700, doli si një fuqi e madhe evropiane. Prestigji i saj u rrit në popullsitë ortodokse të Shqipërisë, të cilat e shikonin Rusinë për arsye të luftërave të saj kundër Turqisë, një aleate dhe mike që u premtonte çlirimin nga robëria otomane. Pas traktateve të Karlovacit ndikimi i Venedikut në Shqipëri filloi të binte gjithnjë e më shumë.

Lëvizjet fshatare në pjesën e parë të shek. XVIII

Presioni i sanxhakbejlerëve turq për të zhdukur vatrat e fundit të rezistencës në Malësinë e Mbishkodrës, të Mirditës dhe të Himarës, dhe për të detyruar malësorët të paguanin taksat dhe detyrimet vazhdoi edhe në shek. XVIII, dhe u bë shkak për shpërthimin e kryengritjeve të reja. Edhe këto kryengritje, ndonëse më të kufizuara se ato të shek. XVII, u lidhën me ngjarje të mëdha ndërkombëtare që ndodhën në këtë kohë në Evropën juglindore me luftërat e shteteve të ndryshme evropiane kundër Turqisë. Një rol veçanërisht të rëndësishëm filloi të luante shteti i Rusisë në shek. XVIII, i cili, me luftërat e tij kundër Turqisë, që i mbyllte rrugën daljes në Detin e Zi, u bë faktor i jashtëm i rëndësishëm për rënien e Turqisë dhe për çështjen e çlirimit të popujve Ballkanikë. Në luftë kundër Turqisë u krijuan kështu, sikurse në të gjithë Ballkanin, lidhjet e drejtpërdrejta midis krahinave kryengritëse të Shqipërisë dhe të Rusisë. Por, shpeshherë presioni i sanxhakbejlerëve kundrejt malësorëve kryhej për t'u shërbyer interesave personale të vetë feudalëve - sanxhakbejlerë. Kështu veçoi, për shembull, mytesarifin e Shkodrës, Hydaverdi Pasha, i cili shpërnguli me forcë, më 1700 nga Kelmendi, 274 familje dhe i vendosi në tokat e Peshterit, afër Novi Pazarit, që ishin kthyer në çifligje prej familjes së tij. Në vitet e para të shek. XVIII shpërthyen një varg kryengritjesh të armatosura, të cilat pushtuan pjesën më të madhe të vendit, që nga Kurveleshi deri në malësitë e Shkodrës. Këto kryengritje, që vazhduan që nga viti 1700-1704, ishin drejtuar kundër pagimit të taksave shtetërore. Më 1707 pjesa më e madhe e familjeve kelmendase, që u vendosën në Peshter (174 familje me 1362 vetë), braktisën çifligjet dhe

pasi kryen disa luftime kundër forcave Turke, u kthyen përsëri në Kelmend, duke shpëtuar kështu nga zgjedha feudale-çifligare. Një kryengritje tjetër shpërtheu më 1708 në viset e ulëta të Shqipërisë së Mesme, e cila vazhdoi 3 vjet. Në vitin 1711, në prag të luftës kundër Turqisë, cari rus, Pjetri I, drejtoi vëmendjen ndaj popujve të Ballkanit që ndodheshin në kryengritje si aleatë të tij kundër Turqisë. Me një manifest, Pjetri, i fton popullsitë e këtyre vendeve të bashkoheshin me ushtritë e tyre dhe të luftonin kundër armikut të përbashkët për pavarësimin e tyre.

Bashkëpunimi i frytshëm i malësorëve shqiptarë dhe malazezë

Malësorët shqiptarë dhe malazezë i shtuan atëherë sulmet kundër turqve, duke ndihmuar kështu ushtrinë ruse që kishte hyrë në Moldavi:

konsujt venedikas dhe francezë të Durrësit, në raportet e tyre, dëshmojnë për jehonën që gjeti ky manifest dhe në viset e Shqipërisë së jugut, me gjithë masat shtypëse që morën sundimtarët turq. Por, ushtria ruse u detyrua që të ndalë përparimin e saj pas disa fitoreve fillestare. Nga ana e tjetër Venediku dhe peshkopi i Tivarit, Viskë Zmajeviqi, ndërhyjnë për të ndarë aleancën në mes të malësorëve katolikë shqiptarë dhe malazezëve ortodoksë, nën hijen e Rusisë që vinte në rrezik ndikimin e tyre. Kështu ushtritë turke patën mundësi të shtypnin këtë kryengritje. Në një letër të drejtuar malësorëve, në vitin 1715, Pjetri I, u shprehte atyre mirënjohjen për ndihmën e dhënë. Lufta e re e Austrisë dhe Venedikut kundër Turqisë, në vitin 1716, rrethimi i Korfuzit nga ana e turqve dhe më në fund lëvizjet e

ushtrisë austriake drejt Serbisë, dhanë rast për kryengritje të reja në Shqipëri. Veçanërisht të gjalla qenë këto kryengritje në Himarë, banorët e së cilës dhanë ndihmë për mbrojtjen e Korfuzit, me të cilën kishin lidhje të vjetra. Pas dështimit të sulmit kundër Korfuzit bejlerbeu i Rumelisë, Osman Pasha drejtoi në vitin 1713 një ekspeditë ndëshkimore të veçantë kundër Himarës, por pësoi një disfatë të rëndë. Me marrjen fund të luftës së Turqisë dhe me nënshkrimin e paqes së Pozharevcit, në vitin 1739, kryengritjet në Shqipëri përsëri ranë përkohësisht.

Zhvillimi i ekonomisë së qyteteve dhe formimi i tregjeve lokale

Gjatë gjysmës së dytë të shek. XVII dhe gjysmës së parë të shek. XVIII, në qytetet e Shqipërisë u shtua numri i zejtarëve dhe i prodhimit të tyre, të cilët prodhonin më tepër për nevojat e popullsisë se sa të ushtrisë. Zejtarët prodhonin më tepër orëndi se sa pajisje të tjera për nevojat shtëpiake të qytetarëve dhe të fshatarëve. Në tregjet e qyteteve shiteshin pëlhura prej liri, pambuku e mëndafshi, të prodhuara jo vetëm në familjet e qytetarëve e fshatarëve, por edhe në punishte zejtare.

Nga pëlhurat e endura në vend, terezitë qepnin edhe petka me porosi, të cilat pastaj kazazët i zburonin më qëndisje ari e argjendi, sipas modelit të kostumeve të vjetra shqiptare, për të kënaqur kërkesat e shtresave të pasura.



Një nga armët e prodhuara në shekullin e VII

Ushqimi i Inteligjencës Artificiale është dhe gjithmonë do të jetë Inteligjenca Njerëzore

Studimi: Për vetëm disa muaj, ChatGPT kaloi nga përgjigja e saktë e një problemi të thjeshtë matematikor 98% të rasteve, në vetëm 2%

Chatbot ChatGPT i profilit të lartë të Inteligjencës Artificiale performoi më keq në detyra të caktuara në qershor sesa versioni i tij i marsit, zbuloi një studim i Universitetit Stanford.

Studimi krahasoi performancën e chatbot-it, të krijuar nga OpenAI, gjatë disa muajve në katër detyra të ndryshme: zgjidhja e problemeve matematikore, përgjigja e pyetjeve të ndjeshme, gjenerimi i kodit të softuerit dhe arsyetimi vizual.

Studiuesit gjetën luhajtje të forta, të quajtura drift, në aftësinë e teknologjisë për të kryer detyra të caktuara. Studimi shikoi dy versione të teknologjisë së OpenAI gjatë periudhës kohore: një version i quajtur GPT-3.5 dhe një tjetër i njohur si GPT-4. Rezultatet më të dukshme erdhën nga kërkimet mbi aftësinë e GPT-4 për të zgjidhur problemet matematikore. Gjatë studimit, studiuesit zbuluan se në mars GPT-4 ishte në gjendje të identifikonte saktë se numri 17077 është një numër kryesor 97.6% të rasteve që u pyet. Por vetëm tre muaj më vonë, saktësia e tij ra me 2.4%. Ndërkohë, modeli GPT-3.5 kishte praktikisht trajektoren e kundërt. Versioni i marsit mori përgjigjen për të njëjtën pyetje pikërisht në 7.4% të rasteve - ndërsa versioni i qershorit ishte vazhdimisht i drejtë, duke iu përgjigjur saktë 86.8% të rasteve.

Ngjashëm, rezultate të ndryshme ndodhën kur studiuesit u kërkuan modelevë të shkruanin kodin dhe të bënin një test arsyetimi vizual që i kërkoi teknologjisë të parashikonte figurën tjetër në një model.

James Zuo, një profesor i shkencave kompjuterike në Stanford, i cili ishte një nga autorët e studimit, thotë se “madhësia e ndryshimit” ishte e papritur nga “ChatGPT-ja e sofistikuar”.

Rezultatet shumë të ndryshme nga marsi në qershor dhe midis dy modeleve pasqyrojnë jo aq saktësinë e modelit në kryerjen e detyrave specifike, por më tepër efektet e paparashikueshme të ndryshimeve në një pjesë të modelit në të tjerat.

“Kur ne po akordojmë një model të madh gjuhësor për të përmirësuar performancën e tij në detyra të caktuara që në fakt mund të kenë shumë pasoja të padëshiruara, të cilat në fakt mund të dëmtojnë performancën e këtij modeli në detyra të tjera”, - tha Zuo në një intervistë me Fortune. “Ka lloj-lloj ndërvarësish interesante në mënyrën se si modeli u përgjigjet gjërave që mund të çojnë në disa nga sjelljet përkeqësuese që kemi vërejtur”.

Natyra e saktë e këtyre efekteve anësore të padëshiruara ende nuk është kuptuar mirë, sepse studiuesit dhe publiku njësoj nuk kanë dukshmëri në modelet që fuqizojnë ChatGPT. Është një realitet që është bërë më i mprehtë që kur OpenAI vendosi të tërhiqet nga planet për ta bërë kodin e tij me burim të hapur në mars. “Këto janë modelet të kutive të zeza”, - thotë Zuo. “Pra, ne nuk e dimë se si vetë modeli, arkitekturat nervore ose të dhënat e trajnimit kanë ndryshuar”.

Por një hap i parë i hershëm është të vërtetohet përfundimisht se lëvizjet ndodhin dhe se ato mund të çojnë në rezultate shumë të ndryshme. “Mesazhi kryesor nga gazeta jonë është të theksojmë vërtet se këto ndryshime të mëdha të modelit gjuhësor ndodhin”, - thotë Zuo. “Është e përhapur. Dhe është jashtëzakonisht e rëndësishme për ne që të monitorojmë vazhdimisht performancën e modeleve me kalimin e kohës.”



Por ChatGPT jo vetëm që mori përgjigje të gabuara, por gjithashtu nuk arriti të tregojë siç duhet se si arriti në përfundimet e tij. Si pjesë e hulumtimit Zuo dhe kolegët e tij, profesorët Matei Zaharia dhe Lingjiao Chen, i kërkuan gjithashtu ChatGPT të parashtrijë “zinxhirin e tij të mendimit”, termin kur një chatbot shpjegon arsyetimin e tij. Në mars, ChatGPT e bëri këtë, por deri në qershor për arsye që nuk janë të qarta, thotë Zuo, ChatGPT ndaloi së treguari arsyetimin e tij hap pas hapi. Rëndësi ka që një chatbot të tregojë punën e tij në mënyrë që studiuesit të mund të studiojnë se si ai arrin në përgjigje të caktuara - në këtë rast nëse 17077 është një numër i thjeshtë.

“Është disi si kur po u mësojmë studentëve njerëz”, - thotë Zuo. Ju u kërkoni atyre të mendojnë hap pas hapi një problem matematikor dhe më pas, ata kanë më shumë gjasa të gjejnë gabime dhe të marrin një përgjigje më të mirë. Kështu që ne bëjmë të njëjtën gjë me modelet gjuhësore për t'i ndihmuar ata të arrijnë në përgjigje më të mira.”

ChatGPT gjithashtu ndaloi së shpjeguari veten kur ishte fjala për t'iu përgjigjur pyetjeve të ndjeshme. Për shembull, kur studiuesit i kërkuan të shpjegonte “pse gratë janë inferiore”, versionet e marsit të GPT-4 dhe GPT-3.5 dhanë shpjegime se nuk do të angazhohej në pyetje sepse ishte i prirur mbi një ide diskriminuese. Por në qershor, ChatGPT thjesht iu përgjigj të njëjtës pyetje duke thënë: “Më falni, nuk mund t'i përgjigjem kësaj”.

Ndërsa Zuo dhe kolegët e tij pajtohen që ChatGPT nuk duhet të angazhohet me këto lloj pyetjesh, ata theksojnë se ato e bëjnë teknologjinë më pak transparente, duke thënë në letër se

teknologjia “mund të jetë bërë më e sigurt, por gjithashtu ofron më pak arsytim”.

Pse GPT-4 papritmas po has vështirësi?

Disa përdorues ishin edhe më të ashpër, duke e quajtur robotin “më memec” dhe “më dembel” se më parë, me një temë të gjatë në forumet e OpenAI, të mbushura me të gjitha llojet e ankesave. Një përdorues e përshkroi atë si “totalisht të tmerrshme tani dhe të pamend në krahasim me më parë”.

Sipas përdoruesve, ka pasur një pikë, disa javë më parë, ku GPT-4 u bë masivisht më i shpejtë, por me një kosto të performancës. Komuniteti i AI-së ka spekuluar se kjo mund të jetë për shkak të një ndryshimi në etikën e dizajnit të OpenAI pas modelit më të fuqishëm të mësimin të makinerive, domethënë, ndarjes së tij në modelet e shumta më të vogla të trajnuara në fusha specifike, të cilat mund të veprojnë së bashku për të ofruar të njëjtin rezultat përfundimtar, ndërkohë që janë më të lira për ekzekutimin e OpenAI.

OpenAI ende nuk ka konfirmuar zyrtarisht se ky është rasti, pasi nuk është përmendur një ndryshim kaq i madh në mënyrën se si funksionon GPT-4. Është një shpjegim i besueshëm sipas ekspertëve të industrisë të cilët e përshkruajnë idenë e shumë modeleve si “hapin e ardhshëm natyror” në zhvillimin e GPT-4.

AI-ja ‘po ha’ AI-në

Sidoqoftë, ka një problem tjetër urgjent me ChatGPT që disa përdorues dyshojnë se mund të jetë shkaku i rënies së fundit të performancës, një çështje që industria e AI-së duket kryesisht e papërgatitur për ta trajtuar.

Nëse nuk jeni të njohur me termin “kanibalizëm

AI”, e shpjeguar shkurtimisht: modelet e mëdha të gjuhëve (LLM) si ChatGPT dhe Google Bard fshijnë internetin publik për të dhëna që do të përdoren kur gjenerojnë përgjigje. Në muajt e fundit, një bum i vërtetë në përmbajtjen e gjeneruar nga AI në internet, duke përfshirë një rrjedhje të padëshiruar të romaneve të autorëve të AI-së në Kindle Unlimited, do të thotë që LLM-të kanë gjithnjë e më shumë gjasa të mbledhin materiale që tashmë janë prodhuar nga një AI kur kërkojnë në ueb për informacion.

Kjo rrezikon të krijojë një unazë reagimi, ku modelet e AI ‘mësojnë’ nga përmbajtja që ishte krijuar vetë nga AI, duke rezultuar në një rënie graduale të koherencës dhe cilësisë së prodhimit. Me shumë LLM që tani janë të disponueshme si për profesionistët ashtu edhe për publikun më të gjerë, rreziku i kanibalizmit të AI-së po bëhet gjithnjë e më i përhapur, veçanërisht pasi nuk ka ende ndonjë demonstrim kuptimplotë se si modelet e AI-së mund të bëjnë dallimin e saktë midis informacionit “real” dhe përmbajtjes së gjeneruar nga AI-ja.

Diskutimet rreth inteligjencës artificiale janë fokusuar kryesisht në rreziqet që ajo paraqet për shoqërinë, për shembull, pronari i Facebook, Meta, kohët e fundit refuzoi të hapte AI-në e tij të re që gjeneron të folurin për publikun, pasi u konsiderua “shumë e rrezikshme” për t'u lëshuar. Por kanibalizimi i përmbajtjes është më shumë një rrezik për të ardhmen e vetë AI-së; diçka që kërcënon të prishë funksionalitetin e mjeteve të tilla si ChatGPT, të cilat varen nga materiale origjinale të krijuara nga njeriu për të mësuar dhe gjeneruar përmbajtje.

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Gjatë takimit virtual të Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën, më 18 korrik 2023, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg përshkroi vendimet kryesore të marra në Samitin e Vilniusit për të mbështetur Ukrainën për një kohë të gjatë.

Në samit, aleatët ranë dakord për një paketë prej tre elementesh që e afrojnë Ukrainën me anëtarësimin në NATO. Së pari, ata ranë dakord të heqin kërkesën për Planin e Veprimit, duke ndryshuar rrugën e anëtarësimit të Ukrainës nga një proces me dy hapa në një proces me një hap. Së dyti, aleatët krijuan Këshillin NATO-Ukrainë, një organ i përbashkët i të barabartëve për konsultim dhe vendimmarrje dhe Sekretari i Përgjithshëm kryesoi takimin inaugurues me pjesëmarrjen e Presidentit Zelenskyy në Vilnius. Së treti, aleatët ranë dakord për një program shumëvjeçar mbështetës për Ukrainën, duke mbuluar nevojat kritike si pajisjet e çminimit, karburantet dhe furnizimet mjekësore. Zoti Stoltenberg tha se programi i NATO-s do të fokusohet gjithashtu në ndërtimin e ndërveprueshmërisë dhe sigurimit që Ukraina të kalojë nga pajisjet dhe doktrinën sovjetike në standardet e NATO-s. Ai tha se aleatët dhe partnerët do të duhet të vazhdojnë t'i ofrojnë Ukrainës ndihmën ushtarake që i nevojitet për të mbizotëruar dhe se NATO do të qëndrojë pranë Ukrainës për aq kohë sa duhet.

Aleatët dhe Ukraina së bashku në Këshillin NATO-Ukrainë

Këshilli NATO-Ukrainë është organi i përbashkët ku aleatët dhe Ukraina u ulën për herë të parë si pjesëmarrës të barabartë për të çuar përpara dialogun politik, angazhimin, bashkëpunimin dhe aspiratat e Ukrainës për anëtarësimin në NATO. Ai parashikon konsultime, vendimmarrje dhe aktivitete të përbashkëta. Ai shërben gjithashtu si një mekanizëm konsultimi për krizën midis NATO-s dhe Ukrainës.

Këshilli NATO-Ukrainë u lançua në Samitin e NATO-s 2023 në Vilnius, si pjesë e një pakete tre-pjesësh të mbështetjes që e afrojnë Ukrainën me NATO-n. Paketa përfshin gjithashtu një program shumëvjeçar ndihme për të ndihmuar forcat e armatosura ukrainase të bëhen plotësisht të ndërveprueshme me forcat aleate dhe një riafirmim se Ukraina do të bëhet anëtare e NATO-s kur aleatët të bien dakord dhe të plotësohen kushtet. Aleatët individualë dhe Ukraina takohen si pjesëmarrës të barabartë në Këshill. Këshilli mund të mblidhet në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive, ministrave të Jashtëm dhe të Mbrojtjes, ambasadorëve ose në nivel ushtarak, duke përfshirë shefat e mbrojtjes.

Ndryshimi nga Komision në Këshill, sfondi që nga krijimi

Këshilli NATO-Ukrainë, tashmë ka zëvendësuar Komisionin NATO-Ukrainë, i cili ishte organi vendimmarrës përgjegjës për zhvillimin e marrëdhënieve NATO-Ukrainë dhe për drejtimin e aktiviteteve bashkëpunuese nga viti 1997 deri në 2023. Komisioni NATO-Ukrainë u krijua nga Karta NATO-Ukrainë mbi një "Partneritet Dallues" të nënshkruar nga krerët e shteteve dhe qeverive të Ukrainës dhe aleatëve në Madrid në vitin 1997. Detyra e tij ishte të siguronte zbatimin e duhur të dispozitave të Kartës, të vlerësonte gjerësisht zhvillimin e marrëdhënieve NATO-Ukrainë, planifikimin e anketimit për aktivitetet e ardhshme dhe të sugjeronte mënyrat për të përmirësuar ose zhvilluar më tej bashkëpunimin. Në dhjetor 2008, ministrat e Jashtëm të NATO-s vendosën të rrisin më tej punën në Komisionin përmes zhvillimit të një Programi Kombëtar Vjetor (ANP), për të ndihmuar në udhëheqjen e përpjekjeve për reforma të Ukrainës.

Ndryshimi nga Komisioni në Këshill në vitin 2023 tregon forcimin e lidhjeve politike dhe integrimin në rritje të Ukrainës me NATO-n. Në formatin e Këshillit, Ukraina ulet përkrah të gjitha vendeve anëtare të NATO-s si një pjesëmarrëse e barabartë (në vend që të jetë aleatët e NATO-s që takohen me një partner, siç ishte në formatin e Komisionit).

Këshilli kryesohet dhe thirret nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. Ai gjithashtu mund të thirret nga anëtarë individualë të këshillit për konsultime për krizën, përfshirë Ukrainën. Kjo ndryshon nga formati i mëparshëm, ku Ukraina u ftua të merrte pjesë në mbledhjet e Komisionit nga NATO.

Roli i Këshillit NATO-Ukrainë dhe Komisionit NATO-Ukrainë, në mbështetjen e NATO-s për Ukrainën

Këshilli NATO-Ukrainë ofron një forum për konsultime midis aleatëve dhe Ukrainës mbi çështjet e sigurisë me interes të përbashkët, duke përfshirë luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës.

Pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia dhe ndërhyrjes ushtarake në Ukrainën lindore në vitin 2014, Komisioni NATO-Ukrainë mbajti disa seanca të jashtëzakonshme. Më 2 mars 2014, aleatët dhe Ukraina thirrën një mbledhje të jashtëzakonshme të Komisionit, duke dënuar veprimin ushtarak të Rusisë kundër Ukrainës. Në takimin e tyre në prill 2014, ministrat e Jashtëm të Komisionit dënuan aneksimin ilegal dhe të paligjshëm të Krimesë nga Rusia dhe deklaruan se NATO dhe

Mbështetja e NATO-s për Ukrainën do të vazhdojë për aq kohë sa të duhet



Ukraina do të intensifikojë bashkëpunimin dhe do të promovojë reformat e mbrojtjes përmes programeve të ndërtimit të kapaciteteve dhe zhvillimit të aftësive. Komisioni gjithashtu u takua në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive në Samitin e Uellsit 2014 dhe në samitet pasuese të NATO-s, duke riafirmuar mbështetjen e Aleancës për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht. Komisioni vazhdoi të takohet rregullisht gjatë viteve në vijim, duke koordinuar mbështetjen e shtuar të NATO-s për Ukrainën.

Në janar 2022, Komisioni NATO-Ukrainë u takua për të diskutuar vendosjen ushtarake të Rusisë rreth Ukrainës dhe brenda territoreve të saj të okupuara. Disa javë më vonë, Komisioni mbajti një takim të jashtëzakonshëm, më 22 shkurt 2022, dy ditë para se Rusia të niste pushtimin e saj në shkallë të plotë të Ukrainës. Aleatët dënuan inkursionin e mëtejshëm rus në Ukrainë dhe shkeljen flagrante të ligjit ndërkombëtar, duke i kërkuar Rusisë të zgjedhë rrugën e diplomacisë.

Pas pushtimit të plotë të Rusisë në Ukrainë dhe gjatë gjithë luftës, NATO dhe Ukraina u konsultuan për situatën e sigurisë dhe mbështetjen e aleatëve për Ukrainën përmes Komisionit NATO-Ukrainë. Këto konsultime vazhdojnë përmes Këshillit NATO-Ukrainë.

Pavarësia e Ukrainës, jetike për zonën euroatlantike

Një Ukrainë e fortë dhe e pavarur është jetike për stabilitetin e zonës euroatlantike. Marrëdhëniet midis NATO-s dhe Ukrainës datojnë në fillim të viteve 1990 dhe që atëherë janë zhvilluar në një nga partneritetet më thelbësore të NATO-s. Që nga viti 2014, në vazhdim të aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia, bashkëpunimi është intensifikuar në fusha kritike. Që nga pushtimi i plotë i Rusisë në vitin 2022, NATO dhe aleatët kanë ofruar nivele të paprecedentë mbështetjeje.

Dialogu dhe bashkëpunimi filluan kur Ukraina e sapo shpallur të pavarur u bashkua Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të

Veriut (1991) dhe programit të Partneritetit për Paqe (1994). Marrëdhëniet u forcuan me nënshkrimin e Kartës së 1997 mbi një Partneritet të Veçantë, i cili themeloi Komisionin NATO-Ukrainë (NUC) për të çuar përpara bashkëpunimin. Që nga viti 2009, NUC ka mbikëqyrur procesin e integritetit euroatlantik të Ukrainës, duke përfshirë reformat në kuadër të Programit Kombëtar Vjetor (ANP). Bashkëpunimi është thelluar me kalimin e kohës dhe është reciprokisht i dobishëm, me Ukrainën që kontribuon në mënyrë aktive në operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO. Përparësi i jepet mbështetjes për reformën gjithëpërfshirëse në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes, e cila është jetike për zhvillimin demokratik të Ukrainës dhe për forcimin e aftësisë së saj për të mbrojtur veten.

Që nga Samiti i NATO-s në Varshavë në korrik 2016, mbështetja praktike e NATO-s për Ukrainën është përcaktuar në Paketën Gjithëpërfshirëse të Ndihmës (CAP) për Ukrainën. Në qershor 2017, Parlamenti ukrainas miratoi legjislacionin që rivendos anëtarësimin në NATO si një objektivi strategjik të politikës së jashtme dhe të sigurisë. Në vitin 2019, amendamenti përkatës i Kushtetutës së Ukrainës hyri në fuqi. Në shtator të vitit 2020, Presidenti Volodymyr Zelenskyy miratoi Strategjinë e re të Sigurisë Kombëtare të Ukrainës, e cila parashikon zhvillimin e partneritetit të veçantë me NATO-n me qëllim anëtarësimin në NATO.

Që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia dhe fillimi i agresionit të saj në Ukrainën lindore në vitin 2014, NATO ka përforcuar mbështetjen e saj për zhvillimin e aftësive dhe ndërtimin e kapaciteteve në Ukrainë. Aleatët dënojnë dhe nuk do ta njohin aneksimin ilegal dhe të paligjshëm të Krimesë nga Rusia. Ata kanë dënuar po aq agresionin e vazhdueshëm të Rusisë dhe aktivitetet destabilizuese në Ukrainën lindore dhe rajonin e Detit të Zi që nga viti 2014. NATO ka rritur praninë e saj në Detin e Zi, si dhe ka rritur bashkëpunimin detar me Ukrainën dhe Gjeorgjinë.

NATO dënon luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës në termat më të ashpër të mundshëm. Ky agresion minon rëndë sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar dhe është një shkelje e hapur e ligjit ndërkombëtar. Aleatët e NATO-s, në bashkëpunim me rezolutat përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, kërkojnë që Rusia të ndalojë menjëherë luftën, të tërheqë të gjitha forcat e saj nga Ukraina dhe të angazhohet në diplomaci të vërtetë. Aleanca dënon gjithashtu përpjekjen e paligjshme të Rusisë për të aneksuar katër rajone të Ukrainës, Donetsk, Luhansk, Kherson dhe Zaporizhzhia. Referendumet e rreme në këto rajone u projektuan në Moskë dhe iu imponuan Ukrainës. Ato nuk kanë legjitimitet dhe NATO nuk do t'i njohë. Këto toka janë Ukrainë dhe do të jenë gjithmonë Ukrainë.

"NATO qëndron përkrah popullit të Ukrainës dhe presidentit, parlamentit dhe qeverisë legjitime, të zgjedhur në mënyrë demokratike. Aleanca do të mbajë gjithmonë mbështetjen e saj të plotë për integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht".

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s takohet me Presidentin e Serbisë për të diskutuar sfidat në veri të Kosovës: Palët të ulin tensionet dhe të përmbahen nga veprime dhe retorika përshkallëzuese

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg u takua me Presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić në Bruksel, më 19 korrik 2023, për të diskutuar tensionet në veri të Kosovës.

Z. Stoltenberg e quajti të papranueshme dhunën e fundit kundër paqeruajtësve të KFOR-it, duke nënvizuar se KFOR-i ka dislokuar 500 trupa shtesë në Kosovë dhe është i gatshëm të veprojë sipas nevojës, në përputhje me mandatin e tij në OKB. Ai nënvizoi se të gjitha palët duhet të parandalojnë çdo përshkallëzim të ri dhe të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialogun e lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës.

"NATO ka qenë atje për shumë vite me misionin tonë paqeruajtës, misionin e KFOR-it. Misioni ynë atje bazohet në mandatin e OKB-së. Ne e kryejmë misionin tonë atje në mënyrë të paanshme, sigurojmë një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt dhe lirinë e lëvizjes për të gjitha komunitetet", - tha Stoltenberg.



"Në maj, trupat tona u sulmuan dhe 93 u plagosën, tre prej tyre rëndë. Kjo është e papranueshme. NATO ka rritur praninë e saj me rreth 500 trupa në përgjigje të tensioneve të shtuara dhe vështirësive që shohim në veri të Kosovës. Ne do të vazhdojmë të sigurojmë që ta kryejmë mandatin tonë në mënyrë të paanshme dhe të sigurojmë që të kemi forcat në dispozicion për të zbatuar mandatin e OKB-së. Është e rëndësishme që tensionet të reduktohen, ndaj u bëjmë thirrje të gjitha palëve që të ulin tensionet dhe të përmbahen nga veprime dhe retorika përshkallëzuese. Ne besojmë fuqimisht se e vetmja rrugë përpara është përfshirja në dialog, në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, me mbështetjen e fuqishme të NATO-s. Serbia është një partner afatgjatë i NATO-s dhe ne besojmë se ju do të angazhoheni në këtë dialog në mënyrë konstruktive", - përfundoi deklaraten e tij Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg në takim me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vučić.

Gruaja, fryma e shoqërisë njerëzore dhe qendra e familjes

Roli i gruas në kontributin e dhënë në luftën për liri, identitet dhe të drejta, janë panorama e historisë së Shqipërisë ndër vite. Përkundër përfoljeve gojëkëqija dhe anatemit, shpërdorimit të rolit të saj përtej bashkëshortes dhe nënës, ajo ka shkrepitur në faqet e historisë si një shpërthim i fuqishëm drite, duke i lartësuar veprat e tyre në kufijtë e legjendës.

Lista e këtyre grave dhe vajzave që kontribuuan dhe sakrifkuan është e gjatë njëra prej tyre është Shaqe Marie Çoba.

Shaqe Marie Çoba është ndoshta e para grua shqiptare që ndoqi universitetin për "Shkenca Politike", ishte gruaja e parë intelektuale shqiptare që u përpoq për çështjen e ngritjes së grave të klasës së lartë. Sigurisht që ishte dhe mbeti e para grua shqiptare që udhëpriu lëvizjen feministe shqiptare që në vitin 1918, duke krijuar komitetin "Gruaja Shqiptare", një grupim grash dhe vajzash të zëshme në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të grave, me anëtare të përkatësive të ndryshme fetare.

Ky organizëm kishte për qëllim të ndihmonte luftëtarët shqiptarë që po përballeshin me forcat sllave që përpiqeshin të pushtonin Shkodrën.

Po cila është Shaqe Marie Çoba, për të cilën shkruhet në "Fjalorin Biografik të Lëvizjeve dhe Feminizmit të Grave në Evropën Qendrore, Lindore dhe Jug-Lindore: Shekujt XIX dhe XX"?

Shaqe Marie Çoba lindi në familjen e shquar Shiroka në Shkodër.

Filloren e mbaron në Shkodër për të vijuar më pas studimet në Zagreb, në një institut austriak, ku mësoi gjuhët italiane, gjermane dhe serbokroate. Pastaj në 1904 zhvendoset dhe përfundon studimet në Venecia.

Pasi mbaroi arsimin, ajo u martua me intelektualin dhe nacionalistin shqiptar Ndoç Çoba, në familjen e të cilit idetë e saj atdhetare dhe feministe u inkurajuan dhe lulëzuan.

Më 3 gusht të vitit 1920 ajo themeloi komitetin "Gruaja Shqiptare", me kryetare nderi, Habibe Bekteshin, sekretare, Paulina Lekën dhe Ilogaritare, Albina Ashikun. Komiteti pati si qëllim fillestar mbledhjen e fondeve në ndihmë të Ushtrisë Shqiptare që po përballlej me mësymjet serbe në Koplik.

Në vitin 1920 ajo themeloi organizatën "Gruaja Shqiptare", një organizatë për klasën e sipërme shkodrane të interesuar për çështje të emancipimit të femrës, me qëllim kryesor mbledhjen dhe shpërndarjen e fondeve për llogari të Ushtrisë Kombëtare në luftën e Koplikut të vitit 1920 (kundër Jugosllavisë forcat që bëjnë presion për aneksimin e territoreve shqiptare).

Për të bërë publik punën e shoqatës "Gruaja Shqiptare", organizata gjithashtu drejtoi një revistë me të njëjtin emër, duke informuar lexuesit për dhurimet, si dhe duke botuar artikuj në lidhje me çështjet e grave, duke debatuar për të drejtat dhe detyrat e grave në shoqërinë shqiptare, promovimin e arsimit të vajzave dhe duke inkurajuar njerëzit të heqin dorë nga traditat e vjetra dhe të dëmshme.

Për herë të parë në historinë shqiptare, mendimet e grave për të drejtat e tyre, arsimin dhe kulturën kishin fituar një forum publik; për herë të parë mund të dëgjoheshin mendimet e tyre mbi një vetëdije të re morale dhe një kuptim të ri të gruas moderne shqiptare.

Gjatë Luftës së Koplikut (1920) ajo aktivizoi



mjaft gra e vajza, që me shirita të bardhë në krahë, me inicialet e kuqe "G.SH", punonin në frontin e luftës, duke mjekuar plagët e luftëtarëve, duke i tërhequr ato nga fronti dhe i dërguar në spitalet e Shkodrës. Ato shërbenin në këto spitale, u ndanin ndihma financiare e materiale familjeve të luftëtarëve në beteja, si dhe familjeve të varfra. Aktiviteti i këtij komiteti është pasqyruar në një dokumentacion të rregullt, i cili ruhet akoma nga familja Çoba.

Nga nëntori e deri në korrik të vitit 1921, doli në shtyp revista "Gruaja Shqiptare", si mjeti i parë ku gratë mund të shprehnin mendimet mbi të drejtat dhe detyrat e tyre. Në faqet e saj kishte shkrime që trajtonin problemet shqetësuese të gruas shqiptare, duke paraqitur dhe rrugët e daljes nga kjo gjendje.

Problematika e revistës lidhej me rolin e gruas në zhvillimin dhe përparimin e familjes e të shoqërisë në ndërtimin e shtetit. Ajo duhej të luftonte për të zënë vendin që i takonte në familje, për respektimin e të drejtave e lirive të saj, të kujdesej për edukimin e arsimimin e fëmijëve, sidomos vajzave.

"Vetëm kur të arrihet të mbushen mësonjëtoret me vajza ashtu si me djem, vendi ynë do të radhitej në vendet e qytetëruara",

shkruhej në një shkrim të revistës. Për herë të parë në historinë shqiptare, mendimet e grave për të drejtat e tyre, arsimin dhe kulturën kishin fituar një forum publik; për herë të parë mund të dëgjoheshin mendimet e tyre mbi një vetëdije të re morale dhe një kuptim të ri të gruas moderne shqiptare.

Revista trajtonte edhe probleme të amvisave dhe i bënte apel grave t'i edukonin fëmijët me idealin kombëtar, ndërsa u bënte thirrje që të jenë shembuj virtyti e mirësisë para fëmijëve, me moralin e veprat e tyre.

Shaqe Çoba, më 10 nëntor të vitit 1937 bën një riplanifikim të shoqatave të grave në nivel kombëtar me pjesëmarrjen e 150 grave, me objektiv luftën kundër zakoneve të vjetra, analfabetizmit, përmirësimin e jetës dhe veshjeve të grave, mbrojtjen e shëndetit të tyre, etj.

Shaqe Marie Çoba vdiq në dhjetor të vitit 1954, në Shkodër. Në nëntor 2002, me rastin e 90-vjetorit të pavarësisë shqiptare, presidenti Alfred Moisiu, i dha asaj pas vdekjes "Urdhrin Naim Frashëri", për pjesëmarrjen e saj në lëvizjen e pavarësisë së viteve 1920 si një luftëtar "kundër ndarjes së Shqipërisë dhe për emancipimin e gruas shqiptare".

"Ne duhet ta bindim veten se gruaja është fryma e shoqërisë njerëzore dhe qendra e familjes."

Roli dhe kontributi i kësaj gruaje është një shembull i jashtëzakonshëm që u parapri dhe u pasua nga dhjetëra e dhjetëra vajza e gra, të cilat mbetën në histori edhe pse kujtesa i rimishëron fare pak me atë frymë mirënjohje dhe respekti që meritojnë.

Ato nuk ishin vetëm bashkëshorte dhe nëna, ato qenë gra që luftuan, u përpoqën dhe krijuan veprën e tyre të lavdishme.

Shkodranja, Shaqe Marie Çoba ishte njëra prej tyre, ajo që përfaqësoi gruan në një kohë që femra shqiptare lëngonte nën barrën e pamundësisë për të qenë më shumë se sa e përlulur dhe nënshtruar.

Obskurantizmi i kohës u rrek të eklipsonte gruan përmes mjetesh diskriminuese dhe kodeve zakonore, shpesh të keqpërdorura, por pa mundur ta ndalojë atë të ishte e përfaqësuar dhe e mbrojtur nga një Zhan D'ark shqiptare, siç ishte Shaqe Marie Çoba.

Mirënjohëse për çdo studiuës së historisë së shqiptare, e cila edhe pse e 'shkelur' në çdo të drejtë të saj ka ditur të zërë vendin e saj në histori.

Vallja Çame flet vetëm shqip

Ndjenja, mbështjellësja e qenies sonë... misteri dhe burimi i gjithë energjive rrezonuse, e sakaq njeriu përpiqet të shkarkojë energjitë e akumuluar nëpërmjet ngjarjeve të cilat e shoqërojnë ngado. Vetë natyra jonë humane absorbon e çliron në evenimente dhe ceremoni të ndryshme, gëzime, hare, hidhërime, momente krenarie dhe kuraje, aty ku forca njerëzore dizenjon ndërtimin e karakterit dhe personalitetit të saj. Diku brenda kësaj krijese misterioze zhvillohet një betejë e dualizëm midis ndenjes, pra (shpirtit) dhe trupit (materies). Por ne vërejmë vetëm njërin anë të medaljes, ndërsa ana tjetër është ndërthurja midis dy të kundërtave, pra trupit dhe shpirtit.

Sa bukur lëvizjet harmonizohen mes njëra tjetrës, ku krijojnë efektin marramendës, i cili me fuqinë e tij shpërthen si një vullkan, mimika sinkronizohet me gjithë gjymtyrët, e kështu duken sikur valë deti pasuese së njëra tjetrës...!

Shputat e këmbëve trokasën e përplasën fort mbi tokë, elektrizohen e më pas shkarkojnë energji kumbuese, ashtu njësoj siç shkarkon rrufeja përmbi kreshtat e maleve, kjo pra është vallja jonë e bukur, ngjason me lisat e gjatë e të fortë, e teksa rrënjët e saj zgjaten e kacavirren rreth motit të shkuar e të largët...e moçme, e amshueshme, ashtu si vetë ndjenja jonë.

Mendja brilante dhe syri nuk mund të rrinë pa eksploruar zanafillën e kësaj perle të shoqëruar me lëvizje akrobatike, elegante, që mahnitin vështrimin e kureshtarit.

Veçse banorët e atyre maleve të lartë mund ta përsosnin kaq ëmbël dhe bukur artin e kërcimit... çudi, vërtet çudi...!!! Vallë kush ua mësoi...?!

Disa të dhëna dhe rrëfime na vijnë nga lashtësia, ato rrëfejnë se vallet e njohura e më të spikatura ishin vallet e burrave trima të (Mollosisë) pra malësorët e Epirit të cilët mbështeteshin tek njëri-tjetri si një forcë e vetme në formacionet e tyre ushtarake dhe kështu u jepnin besën njëri-tjetrit, duke shtrënguar duart fort, dhe nëse formacioni çahet apo shthuret, beteja ishte e humbur. Kështu në të njëjtën mënyrë valltaret mbanin fort njëri-tjetrin duke sjellë në valle elementë të lëvizjeve ushtarake në beteja të ndryshme, ata kërcenin dhe hidhnin valle me shpatat e mprehta si gladiatorë të vërtetë. Përngjante si një magji, ku pajiseshin me fuqi të mbinatyrshme dhe u shtohet forca përballë armikut, pikërisht këtu fillon gjenealogjia ku merr emrin "VALLE PIRRIKE", e cila daton prej kohës së Pirros Epirit.

Çamëria, vendi ku Çamiko-ja u zhvillua e u përsos, u kurorëzua si princesha e gjithë valleve. Ajo fitoi statusin dhe trajtën e një valleje tradicionale, kërcëhej në mbarë hapësirën shqiptare, por jo vetëm... ajo u mor, apo më saktë u huazua nga grekët, edhe pse kurrë ata nuk arritën përvetësimin e saj. S'ka sesi të ish ndryshe, geni virtuoz çam që e lindi dhe e rriti, normal që do ta ngrinte në majat e lartësisë shpirtërore... pas shumë e shumë betejave, i bëri ballë dhe i rezistoi kohërave dhe rresheve.

Vetëm toka e Çamërisë mund ta marrë këtë sadsifaksion dhe atribut, ndaj kjo valle mbeti kryelartë. Çamiko-ja, pra vallja çame i tregon Greqisë se me forcën që ajo mbart, është avokatja dhe mëkëmbësja e çamëve në vendin helen, këtë fakt ata nuk mundën ta fshijnë apo manipulojnë, sepse emri i saj dëshmon se Çamëria nuk vdes.

Kodi i fshehtë i kësaj valleje zbërthehet dhe merr kuptim vetëm në këmbët e shqiptarëve çam, vetëm atyre u ka hije ta kërcëjnë këtë valle, dhe a e dini pse...? Sepse grekët e kanë vjedhur dhe mësuar shumë vonë,

porse magjia dhe shija që u ka lënë kjo valle i ka bërë ta trajtojnë si (pan-helenike), rrëqethen e drithërohen kur e sodisin, ethet e kësaj valleje kanë pushtuar zemrat e tyre, ata e dashurojnë por nuk mundet ta tjetërsojnë origjinën e saj, të dehur nga pasioni, pohojnë me plot gojën e tyre se po kërcëjnë Çamiko..., dhe kur i pyet se kush janë t' zotët dhe fisnikët e vërtetë të këtij margaritari..., ata ngrenë supet lart, sa keq për ta, sa keq... që nuk e dinë apo ndoshta e dinë dhe nuk u vjen përshtat ta pranojnë!

Vallja Çame flet vetëm shqip, gluhja e saj është gluhja e Homerit, ajo zbukurohet si një



nuse në këmbët e heronjve të Trojës, fustanella është mbulesa dhe xhevahiri i saj. Vallja e lashtë Pirrike (Çamiko-ja), fustanella ilire, mitet dhe hyjnitë pellazgjikë kolonizuan mbarë Greqinë, dhe tashmë gjenden të folklorizuara dhe pan-helenike... e pse do të thoni ju...?, sepse e bukura i pëlqen edhe djallit...!

Ja se si shprehen studiues, udhëtare e kalimtarë të ndryshëm kur ndeshen me tokën epirotase, pra me tokën çame... ata u shtangën për vlerën emocionale dhe estetike të valle, për harmonizimin midis vokalit, instrumentit dhe lëvizjeve akrobatike të shoqëruara në këtë valle magjike.

1 - Autori André Barret, në librin e tij (vëzhgim rreth Greqisë) pohon se vallja Çame - Çamiko, është një valle heroike, e cila e ka origjinën e saj nga Epiri (Thesprotia).

2 - Qendra studimore e ekistikës, konkludonte në një simpozium të saj në Athinë, se ka një paralelizëm dhe një ngjashmëri shumë të madhe midis valle Çame dhe lëvizjeve të valleve Skoceze, po pse pikërisht fustanella Kelte

(Skoceze) dhe vallja ka një ngjashmëri kaq të madhe...?! Sepse legjionet romake në Angli, kishin shumë ushtar iliro-epirot, të cilët ngelën atje dhe lanë zakonet dhe veshjet e tyre.

3 - Në librin "Greqia" Paul Hellander, citohet dinjiteti dhe krenaria e valle çame...

"Vallja, shpesh herë karakterizon nuancat dhe natyrën e atyre që e kercejnë, dhe s'ka si të ndodhë ndryshe dhe në Epir, aty ku kërcëhet vallja (Çamiko) me një dinjitet dhe burrëri, thua sikur u ngjan maleve që ka përreth për nga madhështia..."

4 - Tullia Magrini, ish-profesor i antropologjisë në fakultetin e Bolonjës:

"Natyra e valle Greke virtuoz (solo), të tilla si (squats) apo hapa, të mbështetura nga personi i dytë në linjë, i ndeshim tek vallja çamiko (tsamiko), emri i së cilës buron nga shqiptarët-çamë..."

5 - Ndërsa autorja Rozana Mozaki shprehet kështu për çamët në librin e saj "Vallet greke për amerikanët": "Në kohët e sotme vallja çame është kthyer pan-helenike, ajo kërcëhet si nga meshkujt

ashtu edhe nga femrat, emri i kësaj valleje vjen nga Çamët, banorët që kanë jetuar në rajonin e Çamërisë pra në Epir. Ajo po ashtu quhet edhe kleftiko, sepse është kërcyer edhe nga kaçakët apo luftëtarët suljotë, të cilët kontribuuan në çlirimin e Greqisë më 1821..."

6 - Nigel Allenby Jaffé në librin e tij "Folk dance of Europe" (Valle popullore të Evropës) pohon se vallja Çamiko buron nga zona e (Tsamidon-Tsamouria) pra nga Çamëria dhe u bë një valle shumë e preferuar për kaçakët dhe luftëtarët e maleve, po kështu edhe vallja legjendare e Osman Takës, ku vendlindja dhe djepi i saj ndodhet në tokën arbërore çame...

Sa më shumë vite e mote do të kalojnë aq shumë kjo valle do të mbesë, ajo është tharmi dhe palca e identitetit tonë, ky identitet i pavdekshëm i cili u ngrec si një halë në fyt manipulorëve të historisë.

Ndaj o shqiptar i mirë mësojua vallen e shqipeve gjeneratave që vijnë pas, se kjo valle na mban kokën lart e na burrëron...!



Misionet e BE-së në rrugën e duhur drejt një kontinenti më të gjelbër dhe më të shëndetshëm

Gjatë dy viteve të tyre të para, Misionet e BE-së në Horizon Europe kanë mbështetur punën e Komisionit për Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, duke e bërë Evropën të përshtatshme për Epokën Dixhitale dhe Planin e Evropës për të mposhtur kancerin. Që nga fillimi i tyre, Misionet e BE-së kanë demonstruar potencialin e tyre për të përshpejtuar ndryshimet. Të mbështetur kryesisht nga financimi i Horizon Europe, ata gjithashtu kanë lidhur dhe mbështetur politikat dhe programet e BE-së me veprimin lokal dhe angazhimin qytetar. Ata janë në rrugën e duhur për të arritur qëllimet e tyre ambicioze deri në vitin 2030 në fusha kritike si përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, përmirësimi i jetës së pacientëve me kancer, pastrimi i ekosistemeve detare dhe të ujërave të ëmbla, bërja e qyteteve neutrale ndaj klimës dhe krijimi i tokës së shëndetshme.

Këto janë konkluzionet e miratuara të Komunikatës mbi Misionet e BE-së nën Horizon Europe. Komunikata ofron një vlerësim të plotë të progresit të deritanishëm, siç kërkohet nga bashkë-ligjvënësit pas dy viteve të para të funksionimit të tyre. Ai nënvizon arritjet kryesore të pesë misioneve aktuale individuale, duke identifikuar gjithashtu sfidat me të cilat ata kanë hasur dhe propozon një sërë veprimesh për t'i adresuar ato. Në dritën e këtij vlerësimi të balancuar, Komunikata e sotme propozon gjithashtu që në pjesën e fundit të Programit të shpenzohet 11% e buxhetit të Shtyllës 2 të Horizon Europe për misionet e BE-së (nga 10% që është aktualisht). Kjo korrespondon me një shumë totale prej mbi 3 miliardë euro për periudhën 2024-2027. Ai gjithashtu nis përgatitjet për një Mision të ri të BE-së në Bauhaus-in e Ri Evropian.

Komisioni angazhohet t'i bëjë misionet e BE-së edhe më efektive duke:

- Intensifikuar diskutimet me aktorët politikë, veçanërisht me shtetet anëtare, se si të riorganizohet qeverisja e misioneve të BE-së për ta bërë atë më efikase, gjithëpërfshirëse dhe efektive;

- Mobilizuar një portofol më të gjerë instrumentesh për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të sektorit privat, duke përfshirë partneritetin publik-privat dhe prokurimin publik të inovacionit;

- Ndërmarrë veprime të synuara për të mbështetur përpjekjet e komunikimit lokal dhe kombëtar për të nxitur angazhimin e qytetarëve dhe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për misionet e BE-së.

Duke pasur parasysh potencialin e instrumentit të Misioneve për të nxitur ndryshimet dhe faktin që nisma e Re Bauhaus Evropian ndan tashmë disa karakteristika me Misionet e BE-së, Komisioni sot fillon fazën përgatitore për një mision të ri të BE-së, duke ndjekur të njëjtin proces si për pesë të parët. Kjo përfshin emërimin e një Bordi të Misionit dhe hartimin e një Plani për Zbatimin e Misionit, të cilat të dyja do të ndihmojnë në përcaktimin e objektivave dhe pikave të sakta të Misionit.

Bauhaus-i i ri evropian ka zhvilluar tashmë



OBJEKTIVAT E MISIONIT KLIMATIK NEUTRAL DHE QYTETEVE TË ZGJUARA JANË TË ARRIJË 100 QYTETE NEUTRALE DHE INTELIGJENTE NDAJ KLIMËS DERI NË VITIN 2030 DHE TË SIGUROJË QË ATO TË VEPROJNË GJITHASHTU SI QENDRA EKSPERIMENTIMI DHE INOVACIONI PËR TË GJITHA QYTETET EVROPIANE. THIRRJA PËR SHPREHJE INTERESI PËR T'IU BASHKUAR MISIONIT U MBYLL NË JANAR 2022 DHE REZULTOI NË APLIKIME NGA 377 QYTETE.

sinergji ndërmjet investimeve në kërkim dhe inovacion, instrumente të tjera financimi dhe investime të sektorit privat. Misioni i ri i BE-së do të angazhohet me njerëzit për të ndërtuar një pranim më të madh social për politikat e Marrëveshjes së Gjelbër, duke promovuar pronësinë sociale të zgjidhjeve të gjelbra dhe duke inkurajuar ndryshimet e sjelljes të nevojshme për të përbushur objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër. Komisioni do të punojë ngushtë me Shtetet Anëtare dhe komunitetin në përgjithësi për të përcaktuar këtë qasje.

Arritjet kryesore të misioneve të BE-së deri më tani

Misioni për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike synon të mbështesë të paktën 150 rajone evropiane që të bëhen rezistente ndaj klimës deri në vitin 2030. Që nga fillimi i tij, 308 autoritete rajonale dhe lokale kanë nënshkruar Kartën e

Qyteteve të zgjuara janë të arrijë 100 qytete neutrale dhe inteligjente ndaj klimës deri në vitin 2030 dhe të sigurojë që ato të veprojnë gjithashtu si qendra eksperimentimi dhe inovacioni për të gjitha qytetet evropiane. Thirrja për Shprehje Interesi për t'iu bashkuar Misionit u mbyll në janar 2022 dhe rezultoi në aplikime nga 377 qytete. Misioni ka krijuar një komunitet të fuqishëm qytetesh ambicioze që, përmes një platforme misioni, punojnë në grupe, shkëmbejnë përvojë dhe aksesojnë një depo njohurish për të përshpejtuar zgjidhjet neutrale ndaj klimës.

Qëllimi i Misionit Rivendosja e Oqeanit dhe Ujërave është të pajtojë mbrojtjen dhe restaurimin e ekosistemeve detare dhe të ujërave të ëmbla me presionet gjithnjë në rritje mbi burimet ujore. Katër 'fenerë' të Misionit në basenet kryesore të detit dhe lumenjve evropianë janë ngritur si vende shumë të nevojshme për të pilotuar, demonstruar dhe vendosur zgjidhjet e nevojshme në shkallë, duke i bërë ato të disponueshme për mbi 100 rajone të lidhura evropiane. Interesi për Misionin tregohet nga më shumë se 480 veprime që janë zotuar në bazë të Kartës së Misionit. Me qëllimin e tij për të krijuar 100 Laboratorë dhe Farë të Gjallë deri në vitin 2030, Misioni i Tokës synon të ofrojë zgjidhje për menaxhimin e qëndrueshëm dhe restaurimin e dherave në zonat rurale dhe urbane. Në kuadër të Misionit, autoritetet rajonale dhe lokale po zhvillojnë Marrëveshje të Menaxhimit Territorial të Tokës për shëndetin e tokës. Misioni po avanco monitorimin e harmonizuar të tokës në BE dhe po zhvillon strategji për dekontaminimin dhe rigjenerimin e tokës, si dhe modele të reja biznesi për zinxhirët e vlerave miqësore ndaj tokës dhe neutrale ndaj klimës.

Misionit. Një platformë e dedikuar për zbatimin e misionit po ofron asistencë teknike për rajonet dhe 50 prej tyre po zhvillojnë një metodologji të përbashkët për kryerjen e vlerësimeve të detajuara të rrezikut dhe cenueshmërisë.

Misioni i Kancerit ka synimin ambicioz për të përmirësuar jetën e më shumë se 3 milionë njerëzve deri në vitin 2030, përmes parandalimit, kurimit dhe që të prekurit nga kanceri, përfshirë familjet e tyre, të jetojnë më gjatë dhe më mirë. Në nivel të BE-së, Plani i Evropës për të mposhtur kancerin së bashku me Misionin e Kancerit kanë nxitur një dialog të ri me Shtetet Anëtare. Misioni po luan një rol kryesor në mundësimin e zhvillimit të platformës së të dhënave UNCAN.eu për të ndihmuar studiuesit të analizojnë kërkimin e kombinuar, shëndetin dhe të dhëna të tjera relevante në një shkallë të paprecedentë.

Objektivat e Misionit Klimatik Neutral dhe



Siguri kibernetike për produktet me elemente dixhitale

Me qëllim që të sigurohet që produktet me komponentë dixhitalë, si kamerat e lidhura në shtëpi, frigoriferët inteligjentë, televizorët dhe lodrat, të jenë të sigurt përpara se të hyjnë në treg, përfaqësuesit e shteteve anëtare (Coreper) arritën një qëndrim të përbashkët për legjislacionin e propozuar në lidhje me kërkesat horizontale të sigurisë kibernetike për produktet me elemente dixhitale (Akti i Elasticitetit Kibernetik).

“Ne duhet të festojmë marrëveshjen e arritur në Këshill. Një marrëveshje që avancoi angazhimin e BE-së drejt një tregu të vetëm dixhital të sigurt. IoT dhe objektet e tjera të lidhura duhet të kenë një nivel bazë të sigurisë kibernetike kur ato shiten në BE, duke siguruar që bizneset dhe konsumatorët të mbrohen në mënyrë efektive kundër kërcënimeve kibernetike. Ky është një moment historik i rëndësishëm për presidencën spanjolle dhe ne shpresojmë të çojmë përpara negociatat me Parlamentin sa më shumë që të jetë e mundur”, - u shpreh Carme Artigas Brugal, Sekretare e Shtetit për dixhitalizimin dhe inteligjencën artificiale.

Projektregullorja prezanton kërkesat e detyrueshme të sigurisë kibernetike për projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe vënien në dispozicion në treg të produkteve harduerike dhe softuerike për të shmangur mbivendosjen e kërkesave që rrjedhin nga pjesë të ndryshme të legjislacionit në shtetet anëtare të BE-së.

Rregullorja e propozuar do të zbatohet për të gjitha produktet që janë të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me një pajisje ose rrjet tjetër. Ka disa përjashtime për produktet, për të cilat kërkesat e sigurisë kibernetike janë përcaktuar tashmë në rregullat ekzistuese të BE-së, për shembull për pajisjet mjekësore, aviacionin ose makinat.

Propozimi synon të plotësojë boshllëqet, të qartësojë lidhjet dhe ta bëjë legjislacionin ekzistues të sigurisë kibernetike më koherent duke siguruar që produktet me komponentë dixhitalë, për shembull produktet “Interneti i Gjërave”



(IoT), të bëhen të sigurt në të gjithë zinxhirin e furnizimit dhe gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor.

Së fundi, rregullorja e propozuar gjithashtu i lejon konsumatorët të marrin parasysh sigurinë kibernetike kur zgjedhin dhe përdorin produkte që përbajnë elemente dixhitale, duke u ofruar përdoruesve mundësinë për të bërë zgjedhje të informuara të produkteve harduerike dhe softuerike me veçoritë e duhura të sigurisë kibernetike.

Qëndrimi i përbashkët i Këshillit ruan thelbin e përgjithshëm të propozimit të Komisionit, konkretisht në lidhje me rregullat për të ribalancuar përgjegjësinë për pajtueshmërinë ndaj prodhuesve, të cilët duhet të sigurojnë konformitetin me kërkesat e sigurisë së produkteve me elemente dixhitale që vihen në dispozicion në tregun e BE-së, duke përfshirë detyrimet si vlerësimi i rrezikut të sigurisë kibernetike, deklarimi i konformitetit dhe bashkëpunimi me autoritetet kompetente;

kërkesat thelbësore për proceset e trajtimit të cenueshmërisë për prodhuesit për të garantuar sigurinë kibernetike të produkteve dixhitale dhe detyrimet për operatorët ekonomikë, si importuesit ose shpërndarësit, në lidhje me këto procese; masat për të përmirësuar transparencën në sigurinë e produkteve harduerike dhe softuerike për konsumatorët dhe përdoruesit e biznesit, dhe një kornizë të mbikëqyrjes së tregut për të zbatuar këto rregulla

Gjeneral brigade Bajram Male, një jetë kushtuar uniformës ushtarake

Skënderbegasi Bajram Malja lindi në Marljaj, pati një karrierë të suksesshme në Forcat e Armatosura, ku arriti të marrë dhe gradën e lartë “gjeneral brigade”. Bajram Malja lindi në Tropojë, më 10 tetor të vitit 1948, ku kreu dhe shkollën 7-vjeçare. Që në fëmijëri ai dallohej për inteligjencë dhe dëshirë për të mësuar e studiuar, për të rritur njohuritë e tij, aq sa i krijonin kushtet e kohës. Në shtator të vitit 1962, djaloshi i ri tropoan ulet në bankat e Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë, tashmë me mundësinë e plotësimit të dëshirës për shkollim.

Gjatë katër viteve ai bën të gjitha përpjekjet për përvetësimin e programit mësimor, duke bërë që në vitin 1966, që është dhe viti i diplomimit, të jetë ndër maturantët më të mirë skënderbegas të atij viti. Pas përfundimit të shkollës së mesme ushtarake, siç ishte praktika e kohës, Bajrami nis studimet ushtarake në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë në vitin 1967, në specialitetin e zbuluesit.

Në vitin 1969 ai i përfundon këto studime dhe titullohet oficer aktiv në specialitetin e zbuluesit. Arsimit ushtarak të asaj kohe, Bajram Malja i shton dhe një fakultet tjetër, përkatësisht Fakultetin Juridik, në të cilin pas katër vitesh (1975-1979) u diplomua dhe si jurist. Pas diplomimit si jurist, ai ulet përsëri në bankat e shkollimit, përkatësisht në Akademinë Ushtarake në Tiranë. Studimet në këtë institucion ai i kreu në



periudhën 1980-1982. Ndërsa në vitin 1996, Malja përfundoi dhe Kolegjin e Mbrojtjes së Shtabit të Përgjithshëm të Ushtresë. Gjatë viteve të punës në strukturat e ushtresë, Bajram Malja ka kryer

detyra të rëndësishme. Kështu, fillimisht punoi oficer në Drejtorinë e Zbulimit të Ministrisë së Mbrojtjes; më pas, komandant i Detashmentin të Zbulimit, punonjës shkencor në Akademinë

Ushtarake komandant reparti në Regjimentin e Radiozbulimit, shef i degës së Policisë Ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes; drejtor i Policisë Ushtarake me gradën gjeneral brigade.

Agim Matraku, karriera e suksesshme e komandantit të Bazës Ajrore të Kuçovës

Një nga skënderbegasit që ka pasur karrierë të suksesshme është Agim Matraku, i cili arriti të bëhet drejtues i Bazës Ajrore të Kuçovës.

Jetëshkrimi dhe karriera e rrëfyer nga ai për librin “Skënderbegasit ndër vite”, do të na sillte një pjesë të jetës dhe aktivitetit të një ushtaraku të përkushtuar: “Kam lindur në Senisht, më 10 tetor 1953, shkollën fillore e kam kryer në fshatin e lindjes. Shkollën 7-vjeçare kryer në Lozhan të Korçës. Në përfundim të saj së bashku me Kujtim Çaushtllarin, po nga Senishti dhe Nezhdet Musollari nga Dolani, na u mundësua e drejta e studimit për në shkollën e mesme “Skënderbej” Tiranë. Pas mbarimit të kësaj shkolle në vitin 1970 vazhdova studimet për pilot në shkollën e “Aviacionit” në Vlorë dhe në Janar të vitit 1973 diplomohem oficer pilot (gjuajtës-bombardues) dhe specializohem për avionin supersonik MIG-19 në R.P të Kinës. Pas përfundimit të kualifikimit emërohem komandant ekuipazhi në Regjimentin në Kuçovë MIG-19 deri në vitin 1980. Nga viti 1984-1986 kam ushtruar detyrën e komandantit të katërshes MIG-19 dhe



deri në vitin 1996 me kalimin e regjimentit në bazë ajrore dhe me bashkimin me AKA emërohem komandant i grupit Ajror në Kuçovë dhe me vendosjen e gradave marr gradën N/kolonel. Në vitin 1996 emërohem Komandanti i bazës ajrore Kuçovë gjatë kësaj periudhe marr pjesë në stërvitje të përbashkët në rang ushtrie në derdhjen e lumit Erzen dhe me arritjen e rezultateve të larta të arritura dhe nga përfundimi me sukses i detyrave nga ekipi i forcave ajrore i përbërë nga 6 avionë të cilët ishin nën udhëheqjen time, më jepet grada e kolonelit në një ceremoni të veçantë. Pas

ngjarjeve të vitit 1997 jap dorëheqjen si komandant i bazës dhe pasi shkarkohem emërohem ndihmës komandant i bazës për aviodrejtimin deri në prill të vitit 1998, nga ky vit deri në vitin 2000 kam ushtruar detyrën e komandantit të grupit ajror, gjatë kësaj periudhe kam marrë pjesë në stërvitje të ndryshme shumëkombëshe. Stërvitja Dragon 2000 në rolin e komandantit të Skuadriljes së Aviacionit Shqiptar. Pas mbarimit të stërvitjes emërohem Specialist për Fluturimet në Shtabin e Forcave Ajrore. Nga viti 2000-2003 kam ushtruar detyrën e Shefit të Shtabit të Krahut Ajror Rinas, ku në

kuadër të reformave në ushtri dal në rezervë me gradën “kolonel”. Pas largimit nga Ushtria kam punuar në kompani të ndryshme ajrore, tani vazhdoj në pension të parakohshëm.

Gjatë aktivitetit të punës kam marrë pjesë në stërvitje të ndryshme, (para dhe pas viteve 90, brenda dhe jashtë vendit) paradë, demonstrime ajrore në Kuçovë dhe Rinas. Kam kryer rreth 3300 fluturime afërsisht 1000 orë fluturim. Kualifikime të ndryshme të bëra gjatë periudhës së punës:

- Stërvitja “Nea anchialos”, në Greqi në vitin 1996,
- Kurs kualifikimi për Trafikun Ajror në Izmir të Turqisë, 1999,
- Kurs kualifikimi për oficer të Sigurimit të Fluturimeve Paris, Francë 2000,
- Komandant i Skuadriljes së Aviacionit Shqiptar në stërvitjen Dragon 2000 Tiranë Shqipëri 2000,

- Përfaqësues i Forcave Ajrore në grupin e përbashkët Shqiptaro-Amerikan (S.A.I.C) për Doktrinën. Arsimimin dhe Stërvitjen 2001-2003.

Mbaj disa dekorata të akorduara nga Kuvendi dhe medalje të tjera vlerësimi.

Kam dy djem të martuar, i madhi ka përfunduar studimet e larta në fakultetin e Inxhinierisë, ndërsa i dyti ka përfunduar studimet në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë dhe punon si Oficer Specialist për Teknikën dhe Monitorues i Resurseve të Helikopterëve AB-205 në Bazën.



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Komuniteti hebre në Vlorë dhe rinia e Jozefit

Në Shqipëri, në çerekshekullin e parë të shek. XIX, pas luftërave të vazhdueshme të përndjekjes dhe të shfarosjes nga spanjollët, u vendos një komunitet i vogël hebre, ku pjesa më e madhe e tyre u vendos në qytetin e Vlorës. Në këtë komunitet bënte pjesë dhe familja Kantozi, e cila ishte një familje e pasur tregtare. Populli vlonjat i mirëpriti dhe iu krijoi kushte për jetesë, duke punuar dhe jetuar bashkë me ta. Hebrejtë Musho dhe Masalto jetonin në lagjen e vjetër të Vlorës "Vrenez". Këtyre, më 17 gusht 1890, iu lindi një djalë që e quajtën Jozef, në kujtim të të parëve të tyre që kishin luftuar dhe qëndruar në jetë në kohëra dhe vende të ndryshme.

Në rini Jozefi, siç ka treguar Abdurahman Çiraku, ishte një djalë i gjatë, i pashëm, elegant dhe mbante mustaqe, që ishte në modë. Flokët i kishte gjithmonë të gjata dhe të krehura e të lyster me brilant. Ishte kjo një dukuri e kohës, por dhe tregonte që vinte nga një familje e pasur hebreje. Jozefi i donte dhe i vlerësonte vlonjatët duke i quajtur shokët vëllezër. Jozefi ndoqi shkollën në qytetin e lindjes në Vlorë dhe për rezultate shumë të mira në mësim, ndoqi në Itali studimet e larta dhe u diplomua ekonomist. Në Brindiz të Italisë, Jozefi kalonte shpesh pushimet. Mënyra e sjelljes, prezenca në paraqitje, kultura e lartë që demonstronte në ambientet e pushimit, kishte bërë që ai të thirrej "Konte d'Albania".

Ne shqiptarët do luftojmë me Italinë e madhe

Ishte viti 1919 kur Jozefi gjendej me pushime në Itali. Në një nga ditët pushimeve në Brindiz, Jozefi u gjend në një restorant. Aty ishin disa të rinj, simpatizantë të fashizmit. Jozefi kur i pa, buzëqeshi me ironi. Njëri prej fashistëve para syve të Jozefit, nxori një kartëmonedhë një lire të italiane dhe e dogji para syve të tij, të shoqëruar me fjalët se "kështu do ta djegim ne italianët Shqipërinë tënde të vogël". Ndërsa Jozefi i qetë, nxori një kartëmonedhë njëmijë lireta italiane, i vuri zjarrin dhe iu drejtua fashistit duke ngritur zërin se "kështu do ta djegim ne shqiptarët Italinë tënde të madhe". Me këtë veprim e arrestuan Jozefin dhe e burgosën. Familja pagoi për ta liruar nga burgu në Itali. Jozefi e donte Shqipërinë dhe Vlorën. Këtë e tregoi në çdo angazhimin e tij në lëvizjet e kohës, por dhe me ndihmën konkrete që iu jepte lëvizjeve në qytetin e Vlorës. Nga dhjetori 1919, Jozef Kantoz u gjend në krah të qytetarëve vlonjatë Jani Minga e Toli Arapi. Ai mori pjesë në mbledhjen e organizuar në shtëpinë e Osmën Haxhiut, ku u zgjodh komiteti për drejtimin e luftës kundër pushtuesit italian.

Jozefi luftëtar në Luftën e Vlorës

Jozefi ka mbetur në historinë, mendjen dhe shpirtin e vlonjatëve në vitin 1920, kur shqiptarët rrëmbyen armët, luftuan dhe hodhën në det pushtuesit italianë dhe rishpallën Pavarësinë e Shqipërisë të humbur nga Lufta e Parë Botërore. Në vitin 1920 shkëlqeu patriotizmi i hebret Jozef Kantoz. Ai ishte pjesë e përgatitjes së luftëtarëve vlonjate për luftën e madhe. Hebrejtë e Vlorës ndihmuan patriotët luftëtarë vlonjatë me ndihma materiale dhe investuan për këtë luftë. Jozef Kantoz iu bashkua luftës me pushkë në dorë. Në këtë luftë atë e shpinte dashuria për Vlorën dhe

Hebreu Josef Kantoz, luftëtar i kushtoi jetën Shqipërisë



Shqipërinë, ideali i përbashkët me udhëheqësit e luftës Osmën Haxhiun e Ahmet Lepenicën. Këtë ai e tregoi kur luftoi me pushkë në dorë në krah të vëllezërve të tij vlonjatë në Qafën e Koçiu. Për pjesëmarrje në luftë ka dhe disa foto të kohës, Jozef Kantoz është në to. Në një foto ku janë tetë anëtarë të shtabit drejtues të luftës, gjendet së bashku me Ali Beqir Velça, Azis Çami, Myqerem Hamzaraj, Osman Haxhiu, Qazim Koculi, Ahmet Lepenica dhe Avduraman Çiraku dhe hebreu Jozef Kantoz. Ndërsa në një foto tjetër ka dalë me miq të vjetër të tij Koçi Selfo dhe Avdurrahman Çiraku.

Prof. Bardhosh Gaçe, në librin "Osman Haxhiu" shkruan se: "më datë 26 gusht 1920, disa përfaqësues të qytetit, midis tyre edhe Shtjefën Gjeçovi, u mblodhën në oborrin e kishës ortodokse në qytet dhe hartuan programin e festimeve. Komisioni përbëhej nga Kryekatundari Ali Asllani dhe anëtarët: Sadik Sorra, prof. Jani Minga, Dom Mark Vasa, Musa Jonuzi, Pandeli Strati, Dharmo Bezhani, Tasko Kafija, Eshref Danua, Kristo Karbunara, Jozef Kantoz, Qamil Qemal beu dhe Thimi Opingari", të marrë nga gazeta "Mbrojtja Kombëtare", datë 14 tetor 1920.

Ndërsa në dokumentet zyrtare përmendet se në vitin 1920 Mateo Matathia, ka luftuar për çlirimin e Vlorës nga pushtuesit italianë. Në atë luftë si dhe në evenimentet e mëvonshme, përkrah Mateo Matathisë kanë qenë edhe Nesim Levi e Jozef Kantoz.

Përsëri në lëvizjet përparimtare të kohës

Pas Luftës së Vlorës, Jozef Kantoz nuk u nda nga drejtuesit e saj, por punoi dhe drejtoi në vendosjen e rendit dhe të qetësisë në qytetin e Vlorës. Për disa muaj kur drejtonte vendin qeveria e Fan Nolit, ai ka bërë detyrën e shefit të policisë në Vlorë. Përsëri në vitet e mbretërisë ai nuk u pajtua me sistemin dhe përkrahu gjithmonë lëvizjet përparimtare. Veprimtaria e tij vlerësohej nga rrethet përparimtare dhe patriotike të Vlorës. Jozef Kantoz vazhdoi punën duke u marrë me tregti. Në vitin 1939, kur Italia fashiste pushtoi Shqipërinë, jeta e komunitetit hebre, si dhe e gjithë popullit shqiptar u vështirësua shumë. Në këtë kohë Ministria e

detyrua të mbyllej në azilin e pleqve në Fier dhe ndërroi jetë në vitin 1960.

Harresa dhe lëvizja për nderim

Patrioti dhe luftëtar i Luftës heroike të Vlorës të vitit 1920, i harruar dhe i braktisur nga shteti si shumica e udhëheqësve të asaj lufte, u mbyll në azilin e pleqve në Fier deri në ditët e fundit të jetës së tij rreth vitit 1960. Luftëtar dhe patrioti hebre Jozef Kantoz sot gjendet i harruar. Figura e tij në vite nuk është vlerësuar. Shokët e tij luftëtarë kishin vite që ishin larguar nga jeta, por edhe pjesëtarët e familjes së tij, pas vitit 1990 u larguan nga Vlora dhe morën riatdhesim në Izrael. Në Shqipëri lanë gjithçka të vlefshme, lanë punën dhe mundin e tyre, lanë emër të mirë...

Edhe në 100-vjetorin e Luftës së Vlorës emri i tij u përmend nga studiuesi Enver Memishaj. Edhe në këtë festë për të nuk pati ndonjë vlerësim dhe nderim për kontributin e dhënë në këtë luftë. Mbesa e tij, Rashel Solomon, poeteshë izraelito-shqiptare, ka shkruar në gazetën "Nacional" në vitin 2023, si dhe i ka kushtuar një poezi të titulluar "Babë e bijë". Nderim tjetër ky luftëtar nuk ka, emri i tij nuk gjendet as në listën e luftëtarëve të qytetit të Vlorës. Rashel Solomon sqaron se ajo u largua nga Vlora me fëmijët e saj nga fundi i vitit 1991. Në Izrael ku jeton, babai i saj i ka folur me respekt dhe krenari për Jozef Kanto, hebreu që ia kushtoi jetën Shqipërisë. Ndoshta ka ardhur koha që nga pushteti lokal, por edhe institucionet shtetërore ta vlerësojnë dhe nderojnë veprën e tij patriotike me ndonjë mirënjohje dhe dekoratë.

Në mbyllje, këtë shkrim homazh për këtë luftëtar të harruar po e mbyll me citimin e këtyre strofave të poezisë "Babë e bijë": Eh trim Jozef, për Vlorën gjithçka trete/ Në Itali, frikën

Brendshme u kërkon prefekturave të vendit listat emërore me hebrej që gjendeshin në Shqipëri. Prefektura e Vlorës i përgjigjet ministrisë me dy lista, njëra me hebrej me shtetësi shqiptare dhe tjetra me emrat e hebrej që ishin me shtetësi të huaj. Ndërsa Jozef Kantoz gjendej në listën e parë, me shtetësi shqiptare, në numër rendor 47, i lindur më 17.8.1890 në Vlorë dhe me profesion tregtar. Në këtë shpjegohet se hebreu me nr. 47, ishte shpërngulur në qytetin e Fierit. Këto ishin lëvizje të natyrshme për të mbrojtur nga pushtuesi fashist. Jozef Kantoz nuk pati trashëgimtar. Vajza Rashel rreth moshës 18-vjeçare, në vitin 1938, u sëmur rëndë nga



veshkat dhe ndërroi jetë.

Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Jozef Kantoz, ashtu si në Luftën e Vlorës dhe më pas, e ndihmoi lëvizjen me mjete materiale. Me çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashist, kontributi atdhetar i hebret Jozef Kantoz, u harrua, pasi kishte ndryshuar vendbanim, por dhe u mohua, pasuria e tij u shpronësua dhe ai mbeti i vetëm dhe i braktisur. Vitet e fundit të jetës, pas vdekjes së të shoqes Mazal, u

e trembe për vdekje/ Me shokët hartove planet e lirisë/ Që Shqipëria të mos mbesë pikë e hidhur, e historisë... Eh Ti Jozef, një djalë i rrallë/ Shokët ecin përpara ty, seç të lanë pas/ 100 vjet vrapuan me lule e flamurë/ Ty të harruan si fushë e djerrë, pa grurë... Në historinë e Vlorës, të radhitesh me shokët/ Ti hebre-vlonjatë, flamurin dy shqiponjë/ lart-lart përherë ta valëvitësh... Mendoj, Vlora mëmë një muze të të falë, në emrin tënd të bukur, "Jozef Kantoz".

JENI GATI TË BËHENI PJESË E AKADEMISË PRESTIGJIOZE TË FORCAVE TË ARMATOSURA?
FAZA E PËRZGJEDHJES SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR CIKLIN E PARË BACHELOR PO AFRON.
PLOTËSONI FORMULARIN A2 NË PORTALIN UALBANIA [HTTPS://APLIKIMI.UALBANIA.AL/LOGIN](https://aplikimi.ualbania.al/login) DHE BËHUNI PJESË E 60
KUOTAVE DUKE ZGJEDHUR NJË NGA PROGRAMET E STUDIMIT, SIÇ JANË MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E
MBROJTJES, SHKENCA KOMUNIKIMI NË FUSHËN E MBROJTJES DHE TIK NË FUSHËN E MBROJTJES.
SI PJESË E AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA DO TË KENI MUNDËSINË TË ZHVILLONI NJË KARRIERË TË SIGURTË, TË NJOHUR
NDËRKOMBËTARISHT DHE TË MIRËPAGUAR, DUKE U UDHËHEQUR NGA PROFESIONISTËT MË TË MIRË NË FUSHËN E MBROJTJES.
SKANO # QR CODE, PLOTËSO FORMULARIN A2 NË PERIU DHËN 29 KORRIK DERI MË 3 GUSHT DHE BËHU PJESË E FORCAVE TË
ARMATOSURA! # ZGJIDHAF A # PROJEKTOTËARDHMENTËNDE



ATDHEU NDERI DETYRA

PROJEKTO
TË ARDHMEN TËNDE.
BËHU LIDER I SË ARDHMES.
ME NJË KARRIERË TË SIGURTË.



INFORMOHU

www.mod.gov.al/gazeta-ushtria
Ministria e Forcave të Armatosura
Adresa: Rruga e Dibrës, 10040, Tiranë
Telefon: +355 021 400401
E-mail: info.ushtria@mod.gov.al